



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM
Nr. 70, datë 2.12.2020**

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR RAPORTIN NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM TË
BANKAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 26, pika 1, shkronja “a”, nenit 57, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” dhe nenit 66 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rregullorja “Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave” ¹hyn në fuqi në datën 1 janar 2023, me përjashtimet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të nenit 49.
3. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të rregullores “Për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave”, marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të rregullores. Bankat raportojnë çdo 6 muaj në Bankën e Shqipërisë, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, në lidhje me ecurinë e marrjes së masave dhe krijimin e kushteve.
4. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, raportojnë mbi baza tremujore në Bankën e Shqipërisë, raportin neto të financimit të qëndrueshëm mbi baza individuale, ²të llogaritur në total, në monedhën raportuese, si dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, duke filluar nga muaji mars 2022.
5. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

Elvis ÇIBUKU

KRYETARI

Gent SEJKO

¹ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

² Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

RREGULLORE
“PËR RAPORTIN NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM TË BANKAVE”

(Miratuar me vendimin nr.70 datë 2.12.2020 dhe ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:
 - a) kriterëve dhe rregullave për llogaritjen e raportit neto të financimit të qëndrueshëm të bankave; dhe
 - b) nivelit minimal të raportit neto të financimit të qëndrueshëm.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, të cilat, për thjeshtësi, këtu e më poshtë në këtë rregullore, do të quhen “banka”.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe
- b) të nenit 26, pika 1, shkronja “a”, nenit 57, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” dhe nenit 66 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji “Për bankat”.

Neni 4
Përkufizime

1. ³Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin “Për bankat”, si dhe në rregulloren nr. 27, datë 28.3.2019, “Për raportin e mbulimit me likuiditet” (e cila, për thjeshtësi, në këtë rregullore do të quhet “rregullorja e mbulimit me likuiditet”), në rregulloren nr. 69, datë 18.12.2014, “Për kapitalin rregullator të bankës” (e

³ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

cila, për thjeshtësi, në këtë rregullore do të quhet “rregullorja e kapitalit rregullator”) dhe në rregulloren nr. 63, datë 4.11.2020, “Për raportin e levës financiare të bankave” (e cila, për thjeshtësi, në këtë rregullore do të quhet “rregullorja e raportit të levës financiare”).

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a) “⁴vlera e drejtë (*fair value*) e një grupi netimi (kompensimi)” - nënkupton shumën e vlerave të drejta të të gjitha transaksioneve të përfshira në një grup netimi (kompensimi);
 - b) “banka me rëndësi sistematike” - janë bankat e licencuara dhe që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara si të tilla, sipas vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë, bazuar në rregulloren “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”.

KREU II RAPORTI NETO I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM

Neni 5 Raporti neto i financimit të qëndrueshëm

1. Bankat llogarisin raportin neto të financimit të qëndrueshëm, si raport të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, siç përcaktohet në kreun IV, me financimin e qëndrueshëm të kërkuar, siç përcaktohet në kreun V të kësaj rregulloreje, të shprehur në përqindje, sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Raporti neto i financimit të qëndrueshëm(\%)} = \frac{\text{Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm}}{\text{Financimi i qëndrueshëm i kërkuar}}$$

2. Bankat sigurojnë në çdo kohë një raport neto të financimit të qëndrueshëm, prej të paktën 100%, në baza individuale dhe të konsoliduara, të llogaritur në total, në monedhën raportuese për të gjitha transaksionet, pavarësisht nga monedha e denominimit të tyre, ⁵si dhe një raport neto të financimit të qëndrueshëm, prej të paktën 100% për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme.
3. Në rastet kur raporti neto i financimit të qëndrueshëm i bankës ka rënë ose në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të bjerë, në nivelin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, banka njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë dhe i paraqet asaj një plan për rikthimin e këtij raporti në nivelet e kërkuara në këtë rregullore. Banka raporton në Bankën e Shqipërisë mbi baza ditore, derisa raporti neto i financimit të qëndrueshëm të rikthehet në nivelin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga Banka e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë mund të lejojë një frekuencë më të ulët raportimi nga sa përcaktohet më sipër, duke marrë në konsideratë madhësinë dhe kompleksitetin e bankës.
4. Banka e Shqipërisë monitoron planin e rikthimit të raportit neto të financimit të qëndrueshëm në nivelin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni dhe mund t’i kërkojë bankës rikthimin e këtij

⁴ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

raporti në nivelet e kërkuara, brenda një afati më të shkurtër kohor nga sa banka e kishte parashikuar në plan.

5. Banka duhet të synojë të rivendosë raportin neto të financimit të qëndrueshëm në nivelin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni. Banka e Shqipërisë vlerëson arsyet e mosrespektimit nga ana e bankës të raportit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përpara se të ndërmarrë ndonjë masë mbikëqyrëse.
6. ⁶Bankat llogaritin dhe monitorojnë raportin neto të financimit të qëndrueshëm për totalin (në monedhën raportuese), pavarësisht nga monedha e denominimit të tyre, si dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme. Bankat, në përputhje me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut, përcaktojnë në politikat e tyre të brendshme, kufij për raportin neto të financimit të qëndrueshëm, për monedhën vendase (lek) dhe për çdo monedhë të huaj të rëndësishme dhe monitorojnë në vazhdimësi respektimin e këtyre kufijve.
7. ⁷Shfuqizuar.
8. ⁸Shfuqizuar.
9. Bankat, për qëllime të përllogaritjes së raportit neto të financimit të qëndrueshëm mbi baza të konsoliduara, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, marrin parasysh edhe kërkesat e mëposhtme:
 - a) aktivet dhe zërat jashtë bilancit të filialit/degës së bankës në një vend të huaj, të cilat sipas kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi, që përcaktojnë kërkesën për raportin neto të financimit të qëndrueshëm, janë subjekt i faktorëve të financimit të qëndrueshëm të kërkuar, më të lartë nga sa parashikohet në kreun V të kësaj rregulloreje, për qëllime të konsolidimit, do të jenë subjekt i këtyre faktorëve më të lartë të financimit të kërkuar;
 - b) detyrimet dhe zërat e kapitalit rregullator të filialit/degës së bankës në një vend të huaj, të cilat sipas kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi, që përcaktojnë kërkesën për raportin neto të financimit të qëndrueshëm, janë subjekt i faktorëve të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, më të ulët nga sa parashikohet në kreun IV të kësaj rregulloreje, për qëllime të konsolidimit, do të jenë subjekt i këtyre faktorëve më të ulët të financimit të disponueshëm;
 - c) aktivet e filialit/degës së bankës në një vend të huaj, që plotësojnë kërkesat e parashikuara në rregulloren e mbulimit me likuiditet, nuk do të njihen si aktive likuide për qëllime të konsolidimit, nëse ato nuk kualifikohen si aktive likuide sipas kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi, që përcaktojnë kërkesën për mbulimin me likuiditet;
 - d) për filialin/degën e bankës në një vend të huaj, ku zbatohen kërkesa ligjore/rregullative të ndryshme nga kërkesat për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të parashikuara në këtë rregullore, përllogaritjet për qëllime të konsolidimit do të kryhen sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

⁶ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁷ Shfuqizuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁸ Shfuqizuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KREU III

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR LLOGARITJEN E RAPORTIT NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM

Neni 6

Llogaritja e raportit neto të financimit të qëndrueshëm

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së raportit neto të financimit të qëndrueshëm, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë rregullore, konsiderojnë aktivet, pasivet dhe zërat jashtë bilancit mbi baza bruto.
2. Bankat, për qëllime të llogaritjes së raportit neto të financimit të qëndrueshëm, aplikojnë faktorët e duhur/të përshtatshëm të financimit të qëndrueshëm, të parashikuar në kreun IV dhe V, mbi vlerën kontabël të aktiveve, pasiveve dhe zërave jashtë bilancit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore.
3. Bankat nuk duhet të përllogarisin dy herë financimin e qëndrueshëm të kërkuar dhe financimin e qëndrueshëm të disponueshëm.
4. Bankat, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, në rastet kur një zë/element mund të caktohet në më shumë se një kategori të financimit të qëndrueshëm të kërkuar, e caktojnë në kategorinë e financimit të qëndrueshëm të kërkuar që siguron financimin e qëndrueshëm kontraktual të kërkuar më të lartë për atë zë/element.

Neni 7

Kontratat e derivativëve

1. Bankat zbatojnë kërkesat e këtij neni për të llogaritur shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar për kontratat e derivativëve, siç përcaktohet në kreun IV dhe V të kësaj rregulloreje.
2. Bankat marrin në konsideratë vlerën e drejtë të pozicioneve të derivativëve mbi baza neto, kur këto pozicione përfshihen në të njëjtin grup netimi (kompensimi) që plotëson kërkesat e përcaktuara në nënkreun II të kreut VI të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit. Në rast të kundërt, bankat marrin në konsideratë vlerën e drejtë të pozicioneve të derivativëve mbi baza bruto dhe i trajtojnë këto pozicione si pjesë e grupit të tyre të netimit (kompensimit), për qëllime të kreut V të kësaj rregulloreje.
3. Bankat, të gjitha kontratat e derivativëve të listuara në Aneksin 4, pika 2, shkronjat “a” deri në “e” të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit që përfshijnë shkëmbimin e plotë të shumave të principalit (kryegjësë) brenda së njëjtës ditë, i llogaritin mbi baza neto për të gjitha monedhat, duke përfshirë edhe për qëllime të raportimit për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, edhe kur këto transaksione nuk përfshihen në të njëjtin grup netimi (kompensimi) që plotëson kërkesat e përcaktuara në nënkreun II të kreut VI të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.
4. Bankat, paratë në *cash*, të marra si kolateral për zbutjen e ekspozimit të një pozicioni të derivativëve, i trajtojnë si të tilla (si *cash*) dhe jo si depozita, për të cilat zbatohen kërkesat e kreut IV të kësaj rregulloreje.
5. Bankat përjashtojnë nga llogaritja e raportit neto të financimit të qëndrueshëm, efektin/ndikimin e kontratave të derivativëve, përfshirë nëpërmjet përcaktimit të faktorëve të financimit të qëndrueshëm të kërkuar dhe të fondeve rezervë dhe humbjeve, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) për kontratat që kanë një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj;
- b) kur kundërpartia është Banka e Shqipërisë ose banka qendrore e një vendi të huaj;
- c) kontratat e derivativëve i shërbejnë politikës monetare të Bankës së Shqipërisë/bankës qendrore të vendit të huaj.

Nëse filiali/dega e bankës në një vend të huaj, përfiton nga përjashtimi i përmendur në këtë pikë sipas legjislacionit kombëtar të atij vendi që përcakton kërkesat për financimin e qëndrueshëm neto, ky përjashtim do të merret parasysh për qëllime të konsolidimit.

Neni 8

Netimi/kompensimi i transaksioneve të huadhënies së kolateralizuar dhe transaksioneve të bazuara në tregun e kapitalit

1. Bankat konsiderojnë aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga transaksionet e financimit nëpërmjet titujve me një kundërparti të vetme, mbi baza neto, me kusht që këto aktive dhe detyrime të jenë në përputhje me kërkesat e netimit (kompensimit) të përcaktuara në nenin 10, pika 3, shkronja “b” të rregullores së raportit të levës financiare.

Neni 9

Trajtimi preferencial brenda një grupi

1. Banka e Shqipërisë, pa rënë ndesh me përcaktimet në kreun IV dhe V të kësaj rregulloreje, mund të lejojë bankat, rast pas rasti, të përdorin një faktor më të lartë të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm ose një faktor më të ulët të financimit të qëndrueshëm të kërkuar për aktivet, detyrimet dhe lehtësitë e kredisë ose të likuiditetit, të parevokueshme ose të anulueshme me kushte, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) kundërpartia është një nga subjektet e mëposhtme:
 - i. banka mëmë ose një filial i bankës;
 - ii. një filial tjetër i bankës mëmë.
 - b) ka arsye të besohet që detyrimi ose lehtësia e kredisë ose e likuiditetit e parevokueshme ose e anulueshme me kushte, e marrë nga banka, përbën një burim më të qëndrueshëm financimi, ose që aktivi ose lehtësia e kredisë ose e likuiditetit e parevokueshme ose e anulueshme me kushte, e dhënë nga banka, kërkon më pak financim të qëndrueshëm përgjatë horizontit kohor prej një viti, sesa i njëjti detyrim, aktiv ose lehtësi kredie ose likuiditeti e parevokueshme ose e anulueshme me kushte, e marrë ose e dhënë nga kundërparti të tjera;
 - c) kundërpartia zbaton një faktor të financimit të qëndrueshëm të kërkuar që është i barabartë ose më i madh se faktori më i lartë i financimit të qëndrueshëm i disponueshëm, ose zbaton një faktor të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm që është i barabartë ose më i ulët se faktori më i ulët i financimit të qëndrueshëm të kërkuar;
 - d) banka dhe kundërpartia janë të vendosura në Shqipëri.

KREU IV FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM

NËNKREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 10

Llogaritja e shumës së financimit të qëndrueshëm të disponueshëm

1. Bankat, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë kre, llogarisin shumën e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, duke shumëzuar vlerën kontabël të kategorive ose llojeve të ndryshme të detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator, me faktorët e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, sipas parashikimeve në nënkreun II të këtij kreu. Shuma totale e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm është shuma e vlerave të ponderuara të detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator.
2. Bankat, obligacionet dhe titujt e tjerë të borxhit, të emetuar nga banka dhe të shitur ekskluzivisht në tregun me pakicë dhe që mbahen në një llogari me pakicë, i trajtojnë si kategoria përkatëse e depozitave me pakicë. Bankat parashikojnë kufizime, në mënyrë që këto instrumente të mos blihen dhe mbahen nga palë të tjera, përveç klientëve me pakicë.

Neni 11

Maturiteti i mbetur i detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator

1. Bankat, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë kre, marrin në konsideratë maturitetin e mbetur kontraktual të detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator, për të përcaktuar faktorët e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm që do të zbatohen sipas nënkreut II të këtij kreu.
2. Bankat marrin parasysh opsionet ekzistuese në përcaktimin e maturitetit të mbetur të një detyrimi ose të zërave të kapitalit rregullator, duke supozuar se kundërpartia do ushtrojë opsionin *call* (call options) në datën më të shpejtë të mundshme. Për opsionet që ushtrohen në diskrecionin e bankës, banka merr parasysh faktorët reputacionalë që mund të kufizojnë aftësinë e saj (bankës) për të mos ushtruar opsionin, në veçanti pritshmëritë e tregut që banka mund të shlyejë/paguajë detyrime të caktuara përpara maturitetit të tyre.
3. Bankat trajtojnë depozitat me një periudhë njoftimi të përcaktuar për tërheqjen e fondeve nga depozituesi, në përputhje me periudhën e njoftimit të përcaktuar, dhe depozitat me afat, në përputhje me maturitetin e tyre të mbetur. Bankat, pa rënë ndesh me pikën 2 të këtij neni, në përcaktimin e maturitetit të mbetur të depozitave me pakicë me afat, nuk marrin parasysh opsionet për tërheqjet e parakohshme, ku depozituesi duhet të paguajë një penalitet të konsiderueshëm për tërheqjet e parakohshme që ndodhin në më pak se një vit, penalitet i cili është materialisht më i lartë se humbja e interesit të përlllogaritur deri në datën e tërheqjes, siç përcaktohet në rregulloren e mbulimit me likuiditet).
4. Bankat, për qëllime të përcaktimit të faktorëve të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm që zbatohen në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, trajtojnë çdo pjesë të detyrimeve me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, e cila maturohet në më pak se gjashtë muaj dhe çdo pjesë të detyrimeve të tilla që maturohet për një periudhë midis gjashtë muaj

dhe më pak se një viti, sikur të kenë përkatësisht një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj dhe midis gjashtë muajsh dhe më pak se një vit.

NËNKREU II FAKTORËT E FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM TË DISPONUESHËM

Neni 12 **Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 0%**

1. Bankat, përveçse kur përcaktohet ndryshe në nenet 13 deri 16 të kësaj rregulloreje, për të gjitha detyrimet që nuk kanë një afat maturimi të përcaktuar, përfshirë pozicionet në shitje (pozicionet e shkurtra) ⁹dhe pozicionet me afat të hapur/të papërcaktuar maturimi (*open maturity positions*), zbatojnë një faktor të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 0%, me përjashtim të elementeve të mëposhtme:
 - a) detyrimeve tatimore të shtyra, të cilat do të trajtohen në përputhje me datën më të afërt të mundshme në të cilën mund të realizohen këto detyrime;
 - b) interesave të pakicës, të cilat do të trajtohen në përputhje me afatin e instrumentit përkatës.
2. Bankat, për detyrimet tatimore të shtyra dhe interesat e pakicës të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, në varësi të maturitetit të mbetur efektiv, zbatojnë një prej faktorëve të mëposhtëm:
 - a) 0%, kur maturiteti i mbetur efektiv është më pak se gjashtë muaj;
 - b) 50%, kur maturiteti i mbetur efektiv është të paktën gjashtë muaj, por më pak se një vit;
 - c) 100%, kur maturiteti i mbetur efektiv është një vit ose më shumë.
3. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 0%, për detyrimet e mëposhtme:
 - a) shumat/detyrimet për t'u paguar sipas datës të tregtimit që shkaktohen nga blerja e instrumenteve financiare, e monedhave të huaja dhe e mallrave (*commodities*), që pritet të shlyhen brenda ciklit standard të shlyerjes ose periudhës standarde për shkëmbimin përkatës ose llojin e transaksioneve, ose që nuk kanë arritur të shlyhen por pritet që të shlyhen ndërkohë;
 - b) detyrimet me një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj, ¹⁰të ofruara nga:
 - i. Banka e Shqipërisë;
 - ii. banka qendrore e një vendi të huaj;
 - iii. klientët financiarë;
 - c) çdo detyrim tjetër ose zë ose instrument kapitali që nuk parashikohet në nenet 13 deri 16 të kësaj rregulloreje.
4. ¹¹Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 0% mbi vlerën absolute të diferencës, nëse është negative, midis shumës së vlerave të drejta për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) me vlerë të drejtë pozitive dhe shumës së vlerave të drejta

⁹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁰ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹¹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) me vlerë të drejtë negative, llogaritur në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje.

5. ¹²Bankat, për llogaritjen e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, zbatojnë rregullat e mëposhtme:
- a) marzhi i luhatshmërisë (*variation margin*) i pranuar/marrë nga bankat prej kundërpartive të tyre, do të zbritet nga vlera e drejtë e një grupi netimi (kompensimi) me vlerë të drejtë pozitive, kur kolaterali i përfituar si marzh luhatshmërie (*variation margin*) njihet si aktiv i nivelit 1, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet dhe kur bankat kanë të drejtën ligjore dhe aftësinë operationale për ta ripërdorur atë kolateral;
 - b) i gjithë marzhi i luhatshmërisë (*variation margin*) i postuar nga bankat me kundërpartitë e tyre do të zbritet nga vlera e drejtë e një grupi netimi (kompensimi) me vlerë të drejtë negative.

Neni 13

Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 50%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 50%, për detyrimet e mëposhtme:
- a) depozitat që plotësojnë kriteret për depozitat operationale, sipas përcaktimit në rregulloren e mbulimit me likuiditet;
 - b) detyrimet me një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, ¹³të ofruara nga:
 - i. qeveria shqiptare ose qeveria qendrore e një vendi të huaj;
 - ii. qeveritë rajonale ose autoritetet lokale shqiptare ose të një vendi të huaj;
 - iii. njësitë e sektorit publik shqiptar ose të një vendi të huaj;
 - iv. bankat shumëpalëshe të zhvillimit të parashikuara në nenin 15, pika 3 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe organizatat ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 16 të po të njëjtës rregullore;
 - v. klientët korporata jofinanciare;
 - vi. shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, të licencuara nga një autoritet kompetent, kompanitë e investimeve personale dhe klientët që janë ndërmjetës depozitash, në masën që këto detyrime të mos kualifikohen/klasifikohen sipas shkronjës “a” të kësaj pike;
 - c) detyrimet me maturitet të mbetur kontraktual prej të paktën gjashtë muaj, por më pak se një vit, ¹⁴të ofruara nga:
 - i. Banka e Shqipërisë;
 - ii. banka qendrore e një vendi të huaj;
 - iii. klientët financiarë;
 - d) çdo detyrim tjetër me një maturitet të mbetur prej të paktën gjashtë muaj, por më pak se një vit, që nuk përcaktohet në nenet 14, 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje.

¹² Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹³ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁴ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 14

Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 90%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 90%, për depozitat me pakicë pa afat, depozitat me pakicë me njoftim paraprak më pak se një vit dhe depozitat me pakicë me afat që kanë një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, që plotësojnë kriteret përkatëse për depozitat e tjera me pakicë të përcaktuara në rregulloren e mbulimit me likuiditet.

Neni 15

Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 95%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 95%, për depozitat me pakicë pa afat, depozitat me pakicë me njoftim paraprak më pak se një vit dhe depozitat me pakicë me afat që kanë një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, që plotësojnë kriteret përkatëse për depozitat e qëndrueshme me pakicë të përcaktuara në rregulloren e mbulimit me likuiditet.

Neni 16

Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 100%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 100%, për detyrimet dhe elementet e instrumentet e kapitalit rregullator, të mëposhtëm:
 - a) zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës, përpara zbatimit të rregullimeve të parashikuara në nenet 7 deri në 10, zbritjeve të parashikuara në nenin 11 dhe përjashtimeve kufi të parashikuara në nenin 20 të rregullores së kapitalit rregullator;
 - b) zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë të bankës, përpara zbritjes së zërave/elementeve të përcaktuar në nenin 25 të rregullores së kapitalit rregullator, duke përjashtuar çdo instrument me opsione të qarta ose të përfshira (*explicit or embedded options*), të cilat nëse ¹⁵ushtrohen, reduktojnë maturitetin efektiv të mbetur në më pak se një vit;
 - c) zërat e kapitalit të nivelit të dytë të bankës, përpara zbritjeve të përcaktuara në nenin 33 të rregullores së kapitalit rregullator, me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përjashtuar çdo instrument me opsione të qarta ose të përfshira (*explicit or embedded options*), të cilat nëse ¹⁶ushtrohen, reduktojnë maturitetin efektiv të mbetur në më pak se një vit;
 - d) çdo instrument tjetër i kapitalit të bankës, me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përjashtuar çdo instrument me opsione të qarta ose të përfshira (*explicit or embedded options*), të cilat nëse ¹⁷ushtrohen, reduktojnë maturitetin efektiv të mbetur në më pak se një vit;
 - e) çdo huamarrje e siguruar dhe e pasiguarur dhe detyrim tjetër me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përfshirë depozitat me afat, përveç se kur parashikohet ndryshe në nenet 12 deri 15 të kësaj rregulloreje.

¹⁵ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁶ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁷ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KREU V
FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR

NËNKREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 17
Llogaritja e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar

1. Bankat, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë kre, llogarisin shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar, duke shumëzuar vlerën kontabël të kategorive ose llojeve të ndryshme të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit me faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar që do të zbatohen në përputhje me nënkreun II të këtij kreu. Shuma totale e financimit të qëndrueshëm të kërkuar është shuma e vlerave të ponderuara të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit.
2. Bankat përjashtojnë nga llogaritja e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, aktivet e marra hua (nga bankat), përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, kur këto aktive mbahen në bilancin e bankës dhe banka nuk zotëron pronësinë e këtyre aktiveve. Bankat zbatojnë faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, për aktivet e marra hua nga bankat, përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, kur këto aktive nuk mbahen në bilancin e bankës, por banka zotëron pronësinë e tyre.
3. Bankat, aktivet e dhëna hua prej tyre (bankave), përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, mbi të cilat banka zotëron pronësinë, i konsiderojnë si aktive të barrësuara (*encumbered*) për qëllime të këtij kreu dhe zbatojnë faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, edhe në rastin kur aktivet nuk mbahen në bilancin e bankës. Në rast të kundërt, bankat i përjashtojnë këto aktive nga llogaritja e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar.
4. Bankat, për aktivet e barrësuara me një maturitet të mbetur prej gjashtë muajsh ose më shumë, zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar sipas parashikimeve të nënkreut II të këtij kreu për këto aktive, nëse do të ishin të pabarrësuara, ose faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar, i cili aplikohet në rast të kundërt për këto aktive të barrësuara, cilido nga faktorët është më i lartë. Bankat zbatojnë të njëjtën qasje kur maturiteti i mbetur i aktiveve të barrësuara është më i shkurtër se maturiteti i mbetur i transaksionit që është burimi i barrësimit.
5. Bankat, për aktivet me një periudhë barrësimi të mbetur prej më pak se gjashtë muaj, zbatojnë faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar, në përputhje me nënkreun II për këto aktive, nëse do të ishin të pabarrësuara.
6. Në rastet kur një bankë ripërdor ose rivendos peng një aktiv të marrë hua, përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, kur ky aktiv mbahet si zë jashtë bilancit, transaksioni nëpërmjet të cilit ky aktiv është marrë hua, do të trajtohet si i barrësuar, me kusht që transaksioni nuk mund të maturohet nëse banka nuk e ka kthyer aktivin e marrë hua.

7. Bankat konsiderojnë si të pabarrësuar, aktivet e mëposhtme:
 - a) aktivet e përfshira në një grup ¹⁸(pool), të cilat janë të disponueshme për përdorim të menjëhershëm si garanci (kolateral) me qëllim sigurimin e fondeve shtesë për bankën, nëpërmjet linjave të miratuara të kredisë, ¹⁹por ende të patërhequra/papërdorura, të cilat janë në dispozicion të bankës;
 - b) aktivet që banka ka marrë si garanci për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë në transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e financimit të garantuar ose transaksionet e shkëmbimit të kolateralit dhe që banka mund t'i shesë.
8. ²⁰Bankat, për të shmangur çdo llogaritje të dyfishtë, përjashtojnë aktivet që janë të lidhura me kolateralin, që njihet si marzh i luhatshmërisë (*variation margin*) në përputhje me shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 12 dhe me pikën 3 të nenit 28 të kësaj rregulloreje, që njihet si marzh fillestar i postuar, ose që njihet si një kontribut në fondin e garancisë së një kundërpattie qendrore, në përputhje me shkronjat “a” dhe “b” të nenit 27 të kësaj rregulloreje, nga pjesët e tjera të llogaritjes së shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, në përputhje me këtë kre.
- ²¹9. Bankat përfshijnë në llogaritjen e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, instrumentet financiare, monedhat e huaja dhe mallrat (*commodities*), për të cilat është ekzekutuar një urdhër blerjeje. Bankat përjashtojnë nga llogaritja e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, instrumentet financiare, monedhat e huaja dhe mallrat (*commodities*), për të cilat është ekzekutuar urdhri i shitjes, me kusht që këto transaksione të mos pasqyrohen si derivativë ose transaksione të financimit të garantuar në bilancin e bankave dhe do të pasqyrohen në bilancin e bankave në momentin që shlyhen.

Neni 18

Maturiteti i mbetur i aktiveve

1. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë kre, bankat marrin parasysh maturitetin e mbetur kontraktual të aktiveve të tyre dhe zërave/transaksioneve jashtë bilancit kur përcaktojnë faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar që do të zbatohen për aktivet dhe zërat jashtë bilancit, në përputhje me nënkreun II të këtij kreu.
2. Bankat, kur llogarisin maturitetin e mbetur të një aktivi, marrin parasysh edhe opsionet, bazuar në supozimin se emetuesi ose kundërpattia do të ushtrojë çdo opsion për të zgjatur maturitetin e aktivit. Për opsionet që mund të ushtrohen sipas diskrecionit të bankës, banka merr parasysh faktorët reputacionalë që mund të kufizojnë aftësinë e saj (bankës) për të mos ushtruar opsionin, në veçanti pritshmëritë e tregjeve dhe klientëve që banka duhet të zgjasë maturitetin e aktiveve të caktuara në datën e maturimit të tyre.
3. Me qëllim përcaktimin e faktorëve të financimit të qëndrueshëm të kërkuar që do zbatohen në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, për kreditë me këste me një maturitet kontraktual

¹⁸ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁰ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²¹ Rinumëruar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

të mbetur prej një viti ose më shumë, çdo pjesë e kredisë që maturohet në më pak se gjashtë muaj dhe çdo pjesë e kredisë që maturohet midis gjashtë muaj dhe më pak se një vit do të trajtohet përkatësisht, si kredi me një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj dhe midis gjashtë muaj dhe më pak se një vit.

NËNKREU II FAKTORËT E FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM TË KËRKUAR

Neni 19 **Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 0%**

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 0% për aktivet e mëposhtme:
 - a) aktivet e pabarrësuara, të njohura/pranuara si aktive likuide të nivelit 1, ²²me përjashtim të aktiveve të nivelit 1 ndaj të cilave zbatohet një haircut prej 10% dhe 15%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato plotësojnë ose jo, kërkesat operacionale që parashikohen në atë rregullore;
 - b) rezervat e mbajtura nga banka në Bankën e Shqipërisë ose në bankën qendrore të një vendi të huaj, ²³përfshirë rezervën e detyruar dhe tepricën në llogarinë e rezervës së detyruar;
 - c) të drejtat/pretendimet ndaj Bankës së Shqipërisë ose bankës qendrore të një vendi të huaj, që kanë një maturitet të mbetur më pak se gjashtë muaj;
 - d) shumat e arkëtueshme sipas datës së tregtimit që vijnë nga shitjet e instrumenteve financiare, monedhave të huaja ose mallrave (*commodities*) që pritet të shlyhen brenda ciklit standard të shlyerjes ose periudhës së zakonshme/normale për shkëmbimin përkatës ose llojin e transaksionit, ose që nuk kanë arritur të shlyhen, por që megjithatë pritet të shlyhen;
 - e) shumat për t'u marrë nga transaksionet e financimit nëpërmjet titujve me klientët financiarë, kur këto transaksione kanë një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj, kur këto shuma për t'u marrë janë të garantuara me aktive të nivelit 1, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet dhe kur banka ka të drejtën ligjore dhe aftësinë operacionale të ripërdorë këto aktive përgjatë kohëzgjatjes së transaksionit. Shumat për t'u marrë, bankat i marrin parasysh mbi baza neto, nëse zbatohet neni 8 i kësaj rregulloreje.
2. ²⁴Bankat, për qëllime të përlllogaritjes së raportit neto të financimit të qëndrueshëm mbi baza të konsoliduara, për filialin/degën e bankës në një vend të huaj, ku për rezervat e mbajtura në bankën qendrore të atij vendi zbatohet një faktor i financimit të qëndrueshëm të kërkuar më i lartë, sipas kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi për financimin neto të qëndrueshëm, konsiderojnë këtë faktor më të lartë të financimit të qëndrueshëm të kërkuar.

²² Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²³ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁴ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 20
Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 5%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 5% për aktivet e mëposhtme:
 - a) shumat për t'u marrë nga transaksionet e financimit nëpërmjet titujve me klientët financiarë, kur këto transaksione kanë një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "e" të pikës 1 të nenit 19. Shumat për t'u marrë, bankat i marrin parasysh mbi baza neto, nëse zbatohet neni 8 i kësaj rregulloreje;
 - b) pjesa e patërhequr e lehtësirave të kredive dhe të likuiditetit, të parashikuara në rregulloren e mbulimit me likuiditet;
 - c) produktet e lidhura me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar, të parashikuara në Aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, me një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj.
2. Bankat, për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) të kontratave të derivativëve, zbatojnë një faktor të financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 5% ndaj vlerës së drejtë absolute bruto të grupeve të netimit (kompensimit) të kontratave të derivativëve, pa marrë në konsideratë vlerën e kolateraleve të postuar, kur këto grupe netimi (kompensimi) kanë një vlerë të drejtë negative. Për qëllime të kësaj pike, bankat përcaktojnë vlerën e drejtë si vlerë bruto pa marrë në konsideratë çdo lloj kolaterali të postuar ose pagesat e shlyerjeve dhe arkëtimet e lidhura me ndryshimet e vlerësimit të tregut për të tilla kontrata.

Neni 21
Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 7.5%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 7.5% për produktet e lidhura me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar, të parashikuara në Aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, me një maturitet të mbetur prej të paktën gjashtë muaj, por më pak se një vit.

Neni 22²⁵
Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 10%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 10% për aktivet dhe zërat jashtë bilancit të mëposhtëm:
 - a) aktivet likuide të nivelit 1 ndaj të cilave zbatohet një *haircut* prej 10%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato plotësojnë ose jo kërkesat operacionale që parashikohen në atë rregullore;
 - b) shumat për t'u marrë nga transaksionet me klientët financiarë, që kanë një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "e" të pikës 1 të nenit 19 dhe në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 20 të kësaj rregulloreje;
 - c) produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar, me një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj;

²⁵ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- d) produktet e lidhura me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar, të parashikuara në Aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit, me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë.

Neni 23

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 15%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 15% për aktivet e pabarrësuar, të njohura/pranuara si ²⁶aktive likuide të nivelit 1 ndaj të cilave zbatohet një *haircut* prej 15% dhe si aktive të nivelit 2A, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato plotësojnë ose jo, kërkesat operationale dhe kërkesat mbi përbërjen e rezervës së likuiditetit që parashikohen në atë rregullore.

Neni 24²⁷

Shfuqizuar

Neni 25

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 50%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 50% për aktivet e mëposhtme:
 - a) aktivet e pabarrësuar të njohura/pranuara si aktive të nivelit 2B, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato plotësojnë ose jo, kërkesat operationale dhe kërkesat mbi përbërjen e rezervës së likuiditetit që parashikohen në atë rregullore;
 - b) depozitat e mbajtura nga banka në një institucion tjetër financiar që plotësojnë kriteret për depozitat operationale, siç përcaktohen në rregulloren e mbulimit me likuiditet;
 - c) shumat për t'u marrë nga transaksionet me një maturitet të mbetur më pak se një vit nga:
 - i. qeveria shqiptare ose qeveria qendrore e një vendi të huaj;
 - ii. qeveritë rajonale ose autoritetet lokale shqiptare ose të një vendi të huaj;
 - iii. njësitë e sektorit publik shqiptar ose të një vendi të huaj;
 - iv. bankat shumëpalëshe të zhvillimit të parashikuara në nenin 15, pika 3 dhe organizatat ndërkombëtare të parashikuara në nenin 16 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;
 - v. klientët korporata jofinanciare, klientët me pakicë dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME);
 - vi. shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, të licencuara nga një autoritet kompetent, kompanitë e investimeve personale dhe klientët që janë ndërmjetës depozitash, në masën që këto aktive të mos kualifikohen/klasifikohen sipas shkronjës “b” të kësaj pike;

²⁶ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁷ Shfuqizuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- d) shumat për t'u marrë nga transaksionet me një maturitet të mbetur prej të paktën gjashtë muaj, por më pak se një vit nga:
 - i. Banka e Shqipërisë;
 - ii. banka qendrore e një vendi të huaj;
 - iii. klientët financiarë;
- e) produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar, me një maturitet të mbetur prej të paktën gjashtë muaj, por më pak se një vit;
- f) aktivet e barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën gjashtë muajsh, por më pak se një vit, përveç rasteve kur këtyre aktiveve do t'u caktohej një faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm i kërkuar në përputhje me nenet 26 deri 28 të kësaj rregulloreje, nëse do mbaheshin të pabarrësuar, ku do të zbatohet ky faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar;
- g) çdo aktiv tjetër me një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, përveç se kur përcaktohet ndryshe në nenet 19 deri 24 të kësaj rregulloreje.

Neni 26

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 65%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 65% për aktivet e mëposhtme:
 - a) kreditë e pabarrësuar të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale, me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, me kusht që këtyre kredive u është caktuar një peshë rreziku prej 35% ose më pak, në përputhje me kreun III të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;
 - b) kreditë e pabarrësuar me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përjashtuar kreditë për klientët financiarë dhe kreditë e parashikuara në nenet 19 deri 25 të kësaj rregulloreje, me kusht që këtyre kredive u është caktuar një peshë rreziku prej 35% ose më pak, në përputhje me kreun III të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

Neni 27

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 85%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 85% për aktivet dhe zërat jashtë bilancit të mëposhtëm:
 - a) aktivet dhe zërat jashtë bilancit, përfshirë *cash-in*, e vendosur si marzh fillestar për kontratat e derivativëve, përveç rasteve kur këtyre aktiveve do t'u caktohej një faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje, nëse do të mbaheshin të pabarrësuar, ku do të zbatohet ky faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar;
 - b) aktivet dhe zërat jashtë bilancit, përfshirë *cash-in*, të vendosura si kontribut në fondin e garancisë së një kundërpattie qendrore, përveç rasteve kur do t'u caktohej një faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje, nëse do të mbaheshin të pabarrësuar, ku do të zbatohet ky faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar;

- c) kreditë e pabarrësuar me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përjashtuar kreditë për klientët financiarë dhe kreditë e parashikuara në nenet 19 deri 26 të kësaj rregulloreje, të cilat nuk janë më shumë se 90 ditë në vonesë dhe që u është caktuar një peshë rreziku më shumë se 35% në përputhje me kreun III të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit;
- d) produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar, me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë;
- e) mallrat (*commodities*) e tregtuara fizikisht, përfshirë arin, por duke përjashtuar derivativët e mallrave (*commodities*);
- f) ²⁸titujt e pabarrësuar me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, që nuk janë me probleme dhe që nuk janë klasifikuar si aktive likuide, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.

Neni 28

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 100%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 100% për aktivet e mëposhtme:
 - a) përveç se kur specifikohet ndryshe në këtë kre, çdo aktiv i barrësuar me një maturitet të mbetur një vit ose më shumë;
 - b) çdo aktiv tjetër përveç atyre të parashikuara në nenet 19 deri 27 të kësaj rregulloreje, përfshirë kreditë për klientët financiarë që kanë një maturitet kontraktual të mbetur prej një viti ose më shumë, ekspozimet (kreditë) me probleme, zërat që zbriten nga kapitali rregullator dhe aktivet e qëndrueshme.
2. ²⁹Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 100% ndaj diferencës, nëse është pozitive, midis shumës së vlerave të drejta për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) me vlerë të drejtë pozitive dhe shumës së vlerave të drejta për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) me vlerë të drejtë negative, të llogaritura në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje.
3. ³⁰Bankat, për llogaritjen e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, zbatojnë rregullat e mëposhtme:
 - a) marzhi i luhatshmërisë (*variation margin*) i marrë nga bankat prej kundërpasive të tyre, do të zbritet nga vlera e drejtë e një grupi netimi (kompensimi) me vlerë të drejtë pozitive, kur kolaterali i marrë si marzh luhatshmërie (*variation margin*) njihet si aktiv i nivelit 1 në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet dhe kur bankat kanë të drejtën ligjore dhe aftësinë operationale për ta ripërdorur atë kolateral;
 - b) i gjithë marzhi i luhatshmërisë (*variation margin*) i vendosur nga bankat me kundërpartitë e tyre, do të zbritet nga vlera e drejtë e një grupi netimi (kompensimi) me vlerë të drejtë negative.

²⁸ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

²⁹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁰ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KREU VI

PËRJASHTIME PËR BANKAT ME RËNDËSI JOSISTEMIKE

Neni 29

Përfshirje për bankat me rëndësi josistemike

1. Bankat me rëndësi josistemike, pa rënë ndesh me kërkesat e kreut IV dhe V të kësaj rregulloreje, mund të zgjedhin të llogaritin raportin neto të financimit të qëndrueshëm, si raport midis financimit të qëndrueshëm të disponueshëm të bankës siç përcaktohet në Kreun VII dhe financimit të qëndrueshëm të kërkuar të bankës, siç përcaktohet në Kreun VIII të kësaj rregulloreje.
2. Banka e Shqipërisë kur gjykon se metodologjia e thjeshtuar e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk është e përshtatshme për të identifikuar rrezikun e financimit të një banke me rëndësi josistemike, mund t'i kërkojë bankës që të plotësojë kërkesat e financimit neto të qëndrueshëm, bazuar në dispozitat e kreut IV dhe V të kësaj rregulloreje.

KREU VII

FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM PËR LLOGARITJEN E THJESHTUAR TË RAPORTIT NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM

NËNKREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 30

Llogaritja e thjeshtuar e shumës së financimit të qëndrueshëm të disponueshëm

1. Bankat me rëndësi josistemike, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë kre, llogarisin shumën e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm duke shumëzuar vlerën kontabël të kategorive ose llojeve të ndryshme të detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator, me faktorët e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, sipas parashikimeve në nënkreun II të këtij kreu. Shuma totale e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm është shuma e vlerave të ponderuara të detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator.
2. Bankat, obligacionet dhe titujt e tjerë të borxhit, të emetuar nga banka dhe të shitur ekskluzivisht në tregun me pakicë dhe që mbahen në një llogari me pakicë, i trajtojnë si kategoria përkatëse e depozitave me pakicë. Bankat parashikojnë kufizime, në mënyrë që këto instrumente të mos blihen dhe mbahen nga palë të tjera, përveç klientëve me pakicë.

Neni 31

Maturiteti i mbetur i një detyrimi ose i zërave të kapitalit rregullator

1. Bankat, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë kre, marrin në konsideratë maturitetin e mbetur kontraktual të detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator, për të përcaktuar faktorët e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm që do të zbatohen sipas nënkreut II të këtij kreu.

2. Bankat marrin parasysh opsionet ekzistuese në përcaktimin e maturitetit të mbetur të një detyrimi ose të zërave të kapitalit rregullator, duke supozuar se kundërparsia do ushtrojë opsionin *call* (call options) në datën më të shpejtë të mundshme. Për opsionet që ushtrohen në diskrecionin e bankës, banka merr parasysh faktorët reputacionalë që mund të kufizojnë aftësinë e saj (bankës) për të mos ushtuar opsionin, në veçanti pritshmëritë e tregut që banka mund të shlyejë/paguajë detyrime të caktuara përpara maturitetit të tyre.
3. Bankat trajtojnë depozitat me një periudhë njoftimi të përcaktuar për tërheqjen e fondeve nga depozituesi, në përputhje me periudhën e njoftimit të përcaktuar, dhe depozitat me afat, në përputhje me maturitetin e tyre të mbetur. Bankat, pa rënë ndesh me pikën 2 të këtij neni, në përcaktimin e maturitetit të mbetur të depozitave me pakicë me afat, nuk marrin parasysh opsionet për tërheqjet e parakohshme, ku depozituesi duhet të paguajë një penalitet të konsiderueshëm për tërheqjet e parakohshme që ndodhin në më pak se një vit, penalitet i cili është materialisht më i lartë se humbja e interesit të përlogaritur deri në datën e tërheqjes, siç përcaktohet në rregulloren e mbulimit me likuiditet.
4. Bankat, për qëllime të përcaktimit të faktorëve të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm që zbatohen në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, trajtojnë çdo pjesë të detyrimeve me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, e cila maturohet në më pak se gjashtë muaj dhe çdo pjesë të detyrimeve të tilla që maturohet për një periudhë midis gjashtë muaj dhe më pak se një viti, sikur të kenë përkatësisht një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj dhe midis gjashtë muajsh dhe më pak se një vit.

NËNKREU II FAKTORËT E FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM TË DISPONUESHËM

Neni 32 **Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 0%**

1. Përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë nënkre, bankat për të gjitha detyrimet që nuk kanë një afat maturimi të përcaktuar, përfshirë pozicionet në shitje (pozicionet e shkurtra) ³¹dhe pozicionet me afat të hapur/të papërcaktuar maturimi (*open maturity positions*), do të zbatojnë një faktor të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 0%, me përjashtim të elementeve të mëposhtme:
 - a) detyrimeve tatimore të shtyra, të cilat do të trajtohen në përputhje me datën më të afërt të mundshme në të cilën mund të realizohen këto detyrime;
 - b) interesave të pakicës, të cilat do të trajtohen në përputhje me afatin e instrumentit përkatës.
2. Bankat, për detyrimet tatimore të shtyra dhe interesat e pakicës, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, në varësi të maturitetit të mbetur efektiv, zbatojnë një prej faktorëve të mëposhtëm:
 - a) 0%, kur maturiteti efektiv i mbetur është më pak se një vit;
 - b) 100%, kur maturiteti efektiv i mbetur është një vit ose më shumë.
3. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 0%, për detyrimet e mëposhtme:

³¹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- a) shumat/detyrimet për t'u paguar sipas datës të tregtimit që shkaktohen nga blerja e instrumenteve financiare, e monedhave të huaja dhe e mallrave (*commodities*), që pritet të shlyhen brenda ciklit standard të shlyerjes ose periudhës standarde për shkëmbimin përkatës ose llojin e transaksioneve, ose që nuk kanë arritur të shlyhen por pritet që të shlyhen ndërkohë;
 - b) detyrimet me një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, ³²të ofruara nga:
 - i. Banka e Shqipërisë;
 - ii. banka qendrore e një vendi të huaj;
 - iii. klientët financiarë;
 - c) çdo detyrim tjetër ose zë ose instrument kapitali që nuk parashikohet në këtë nen dhe në nenet 33 deri 36 të kësaj rregulloreje.
4. ³³Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 0% mbi vlerën absolute të diferencës, nëse është negative, midis shumës së vlerave të drejta për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) me vlerë të drejtë pozitive dhe shumës së vlerave të drejta për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) me vlerë të drejtë negative, llogaritur në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje.
5. ³⁴Bankat, për llogaritjen e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, zbatojnë rregullat e mëposhtme:
- a) marzhi i luhatshmërisë (*variation margin*) i pranuar/marrë nga bankat prej kundërpartive të tyre, do të zbritet nga vlera e drejtë e një grupi netimi (kompensimi) me vlerë të drejtë pozitive, kur kolaterali i përfituar si marzh luhatshmërie (*variation margin*) njihet si aktiv i nivelit 1, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet dhe kur bankat kanë të drejtën ligjore dhe aftësinë operacionale për ta ripërdorur atë kolateral;
 - b) i gjithë marzhi i luhatshmërisë (*variation margin*) i postuar nga bankat me kundërpartitë e tyre do të zbritet nga vlera e drejtë e një grupi netimi (kompensimi) me vlerë të drejtë negative.

Neni 33

Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 50%

- 1. Bankat, për detyrimet e mëposhtme, zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 50%:
 - a) depozitat që plotësojnë kriteret për depozitat operacionale, sipas përcaktimit në rregulloren e mbulimit me likuiditet;
 - b) detyrimet me një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, ³⁵të ofruara nga:
 - i. qeveria shqiptare ose qeveria qendrore e një vendi të huaj;
 - ii. qeveritë rajonale ose autoritetet lokale shqiptare ose të një vendi të huaj;
 - iii. njësitë e sektorit publik shqiptar ose të një vendi të huaj;

³² Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³³ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁴ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁵ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- iv. bankat shumëpalëshe të zhvillimit të parashikuara në nenin 15, pika 3 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit dhe organizatat ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 16 të po të njëjtës rregullore;
- v. klientët korporata jofinanciare;
- vi. shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, të licencuara nga një autoritet kompetent, kompanitë e investimeve personale dhe klientët që janë ndërmjetës depozitash, me përjashtim të depozitave të marra që plotësojnë kriteret për depozitat operationale të përcaktuara në rregulloren e mbulimit me likuiditet.

Neni 34

Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 90%

1. Bankat, për depozitat me pakicë pa afat, depozitat me pakicë me njoftim paraprak më pak se një vit dhe depozitat me pakicë me afat që kanë një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, që plotësojnë kriteret përkatëse për depozitat e tjera me pakicë të përcaktuara në rregulloren e mbulimit me likuiditet, zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 90%.

Neni 35

Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 95%

1. Bankat, për depozitat me pakicë pa afat, depozitat me pakicë me njoftim paraprak më pak se një vit dhe depozitat me pakicë me afat që kanë një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, që plotësojnë kriteret përkatëse për depozitat e qëndrueshme me pakicë të përcaktuara në rregulloren e mbulimit me likuiditet, zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 95%.

Neni 36

Faktori i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 100%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 100%, për detyrimet dhe elementet e instrumentet e kapitalit rregullator, të mëposhtëm:
 - a) zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë të bankës, përpara zbatimit të rregullimeve të parashikuara në nenet 7 deri në 10, zbritjeve të parashikuara në nenin 11 dhe përjashtimeve kufi të parashikuara në nenin 20 të rregullores së kapitalit rregullator;
 - b) zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë të bankës, përpara zbritjes së zërave/elementeve të përcaktuar në nenin 25 të rregullores së kapitalit rregullator, duke përjashtuar çdo instrument me opsione të qarta ose të përfshira (*explicit or embedded options*), të cilat nëse ³⁶ushtrohen, reduktojnë maturitetin efektiv të mbetur, në më pak se një vit;
 - c) zërat e kapitalit të nivelit të dytë të bankës, përpara zbritjeve të përcaktuara në nenin 33 të rregullores së kapitalit rregullator, me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përjashtuar çdo instrument me opsione të qarta ose të përfshira (*explicit or embedded options*), të cilat nëse ³⁷ushtrohen, reduktojnë maturitetin efektiv të mbetur, në më pak se një vit;

³⁶ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³⁷ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

- d) çdo instrument tjetër i kapitalit të bankës, me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përjashtuar çdo instrument me opsione të qarta ose të përfshira (*explicit or embedded options*), të cilat nëse ³⁸ushtrohen, reduktojnë maturitetin efektiv të mbetur, në më pak se një vit;
- e) çdo huamarrje e siguruar dhe e pasiguruar dhe detyrim tjetër me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përfshirë depozitat me afat, përveçse kur parashikohet ndryshe në nenet 32 deri 35 të kësaj rregulloreje.

KREU VIII

FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR PËR LLOGARITJEN E THJESHTUAR TË RAPORTIT NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM

NËNKREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 37

Llogaritja e thjeshtuar e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar

1. Bankat me rëndësi josistemike, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë kre, llogarisin shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar, duke shumëzuar vlerën kontabël të kategorive ose llojeve të ndryshme të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit me faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar që do të zbatohen në përputhje me nënkreun II të këtij kreu. Shuma totale e financimit të qëndrueshëm të kërkuar është shuma e vlerave të ponderuara të aktiveve dhe zërave jashtë bilancit.
2. Bankat përjashtojnë nga llogaritja e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, aktivet e marra hua (nga bankat), përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, kur këto aktive mbahen në bilancin e bankës dhe banka nuk zotëron pronësinë e këtyre aktiveve. Bankat zbatojnë faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, për aktivet e marra hua nga bankat, përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, kur këto aktive nuk mbahen në bilancin e bankës, por banka zotëron pronësinë e tyre.
3. Bankat, aktivet e dhëna hua prej tyre (bankave), përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, mbi të cilat banka zotëron pronësinë, i konsiderojnë si aktive të barrësuarra (*encumbered*) për qëllime të këtij kreu dhe zbatojnë faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, edhe në rastin kur aktivet nuk mbahen në bilancin e bankës. Në rast të kundërt, bankat i përjashtojnë këto aktive nga llogaritja e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar.
4. Bankat, për aktivet e barrësuarra me një maturitet të mbetur prej gjashtë muajsh ose më shumë, zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar sipas parashikimeve të nënkreut II të këtij kreu për këto aktive, nëse do të ishin të pabarrësuarra, ose faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar, i cili aplikohet në rast të kundërt për këto aktive të barrësuarra, cili do nga faktorët është më i lartë. Bankat zbatojnë të njëjtën qasje kur maturiteti i mbetur i aktiveve të barrësuarra është më i shkurtër se maturiteti i mbetur i transaksionit që është burimi i barrësimit.

³⁸ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

5. Bankat, për aktivet me një periudhë barrësimi të mbetur prej më pak se gjashtë muaj, zbatojnë faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar, në përputhje me nënkreun II për këto aktive, nëse do të ishin të pabarrësuar.
6. Në rastet kur një bankë ripërdor ose rivendos peng një aktiv të marrë hua, përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, kur ky aktiv mbahet si zë jashtë bilancit, transaksioni nëpërmjet të cilit ky aktiv është marrë hua, do të trajtohet si i barrësuar, me kusht që transaksioni nuk mund të maturohet nëse banka nuk e ka kthyer aktivin e marrë hua.
7. Bankat konsiderojnë si të pabarrësuar, aktivet e mëposhtme:
 - a) aktivet e përfshira në një grup ³⁹(pool), të cilat janë të disponueshme për përdorim të menjëhershëm si garanci (kolateral) me qëllim sigurimin e fondeve shtesë për bankën, nëpërmjet linjave të miratuara të kredisë, ⁴⁰por ende të patërhequra/papërdorura, të cilat janë në dispozicion të bankës;
 - b) aktivet që banka ka marrë si garanci për qëllime të zbutjes së rrezikut të kredisë në transaksionet e huadhënies së kolateralizuar, transaksionet e financimit të garantuar ose transaksionet e shkëmbimit të kolateralit dhe që banka mund t'i shesë.
8. ⁴¹Bankat, për të shmangur çdo llogaritje të dyfishtë, përjashtojnë aktivet që janë të lidhura me kolateralin, që njihet si marzh i luhatshmërisë (*variation margin*) në përputhje me shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 12 dhe me pikën 3 të nenit 28 të kësaj rregulloreje, që njihet si marzh fillestar i postuar, ose që njihet si një kontribut në fondin e garancisë së një kundërpattie qendrore, në përputhje me shkronjat “a” dhe “b” të nenit 27 të kësaj rregulloreje, nga pjesët e tjera të llogaritjes së shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, në përputhje me këtë kre.
- 9.⁴² Bankat përfshijnë në llogaritjen e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, instrumentet financiare, monedhat e huaja dhe mallrat (*commodities*), për të cilat është ekzekutuar një urdhër blerjeje. Bankat përjashtojnë nga llogaritja e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, instrumentet financiare, monedhat e huaja dhe mallrat (*commodities*), për të cilat është ekzekutuar urdhri i shitjes, me kusht që këto transaksione të mos pasqyrohen si derivativë ose transaksione të financimit të garantuar në bilancin e bankave dhe do të pasqyrohen në bilancin e bankave në momentin që shlyhen.

Neni 38 **Maturiteti i mbetur i aktiveve**

1. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë kre, bankat marrin parasysh maturitetin e mbetur kontraktual të aktiveve të tyre dhe zërave/transaksioneve jashtë bilancit kur përcaktojnë faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar që do të zbatohen për aktivet dhe zërat jashtë bilancit, në përputhje me nënkreun II të këtij kreu.
2. Bankat, kur llogarisin maturitetin e mbetur të një aktivi, marrin parasysh edhe opsionet, bazuar në supozimin se emetuesi ose kundërpattia do të ushtrojë çdo opsion për të zgjatur maturitetin e aktivit. Për opsionet që mund të ushtrohen sipas diskrecionit të bankës, banka merr parasysh faktorët reputacionalë që mund të kufizojnë aftësinë e saj (bankës) për të mos

³⁹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁰ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴¹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴² Rinumëruar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

ushtruar opsionin, në veçanti pritshmëritë e tregjeve dhe klientëve që banka duhet të zgjasë maturitetin e aktiveve të caktuara në datën e maturimit të tyre.

3. Me qëllim përcaktimin e faktorëve të financimit të qëndrueshëm të kërkuar që do zbatohen në përputhje me nënkreun II të këtij kreu, për kreditë me këste me një maturitet kontraktual të mbetur prej një viti ose më shumë, çdo pjesë e kredisë që maturohet në më pak se gjashtë muaj dhe çdo pjesë e kredisë që maturohet midis gjashtë muaj dhe më pak se një vit do të trajtohet përkatësisht si kredi me një maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë muaj dhe midis gjashtë muaj dhe më pak se një vit.

NËNKREU II FAKTORËT E FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM TË KËRKUAR

Neni 39 **Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 0%**

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 0% për aktivet e mëposhtme:
 - a) aktivet e pabarrësuar, të njohura/pranuara si aktive likuide të nivelit 1,⁴³ me përjashtim të aktiveve të nivelit 1 ndaj të cilave zbatohet një *haircut* prej 10% dhe 15%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato plotësojnë ose jo, kërkesat operationale që parashikohen në atë rregullore;
 - b) rezervat e mbajtura nga banka në Bankën e Shqipërisë ose në bankën qendrore të një vendi të huaj,⁴⁴ përfshirë rezervën e detyruar dhe tepricën në llogarinë e rezervës së detyruar;
 - c) të drejtat/pretendimet ndaj Bankës së Shqipërisë ose bankës qendrore të një vendi të huaj, që kanë një maturitet të mbetur më pak se gjashtë muaj.
2. ⁴⁵Bankat, për qëllime të përlllogaritjes së raportit neto të financimit të qëndrueshëm mbi baza të konsoliduara, për filialin/degën e bankës në një vend të huaj, ku për rezervat e mbajtura në bankën qendrore të atij vendi zbatohet një faktor i financimit të qëndrueshëm të kërkuar më i lartë, sipas kërkesave ligjore/rregullative të atij vendi për financimin neto të qëndrueshëm, konsiderojnë këtë faktor më të lartë të financimit të qëndrueshëm të kërkuar.

Neni 40 **Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 5%**

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 5% për pjesën e patërhequr të lehtësirave të kredive dhe të likuiditetit, të parashikuara në rregulloren e mbulimit me likuiditet.
2. Bankat, për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) të kontratave të derivativëve, zbatojnë një faktor të financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 5% ndaj vlerës së drejtë absolute bruto të grupeve të netimit (kompensimit) të kontratave të derivativëve, pa marrë në

⁴³ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁴ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁵ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

konsideratë vlerën e kolateraleve të postuar, kur këto grupe netimi (kompensimi) kanë një vlerë të drejtë negative. Për qëllime të kësaj pike, bankat përcaktojnë vlerën e drejtë si vlerë bruto, pa marrë në konsideratë çdo lloj kolaterali të postuar ose pagesat e shlyerjeve dhe arkëtimet e lidhura me ndryshimet e vlerësimit të tregut për të tilla kontrata.

Neni 41

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 10%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 10% ⁴⁶për aktivet likuide të nivelit 1 ndaj të cilave zbatohet një *haircut* prej 10%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato plotësojnë ose jo kërkesat operationale që parashikohen në atë rregullore, si dhe për produktet e lidhura me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar, të parashikuara në Aneksin 2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.

Neni 42

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 20%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 20% për aktivet e pabarrësuar, të njohura/pranuara si ⁴⁷aktive likuide të nivelit 1 ndaj të cilave zbatohet një *haircut* prej 15% dhe si aktive të nivelit 2A, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato plotësojnë ose jo, kërkesat operationale dhe kërkesat mbi përbërjen e rezervës së likuiditetit që parashikohen në atë rregullore.

Neni 43

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 50%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 50% për aktivet e mëposhtme:
 - a) kreditë e siguruar dhe të pasiguar, me një maturitet të mbetur prej më pak se një viti, me kusht që këto kredi janë të barrësuar për më pak se një vit;
 - b) çdo aktiv tjetër me një maturitet të mbetur prej më pak se një vit, përveç se kur përcaktohet ndryshe në nenet 39 deri 42 të kësaj rregulloreje;
 - c) aktivet e barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën gjashtë muajsh, por më pak se një vit, përveç rasteve kur këtyre aktiveve do t'u caktohej një faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm i kërkuar, në përputhje me nenet 44, 45 dhe 46 të kësaj rregulloreje, nëse do mbaheshin të pabarrësuar, ku do të zbatohet ky faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar.

Neni 44

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 55%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 55% për aktivet e pabarrësuar për më pak se një vit, të njohura/pranuara si aktive të nivelit 2B, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato plotësojnë ose jo, kërkesat

⁴⁶ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁷ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

operacionale dhe kërkesat mbi përbërjen e rezervës së likuiditetit që parashikohen në atë rregullore.

Neni 45

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 85%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 85% për aktivet dhe zërat jashtë bilancit të mëposhtëm:
 - a) aktivet dhe zërat jashtë bilancit, përfshirë *cash-in*, e vendosur si marzh fillestar për kontratat e derivativëve ose si kontribut në fondin e garancisë së një kundërpartie qendrore, përveç rasteve kur këtyre aktiveve do t'u caktohej një faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me nenin 46 të kësaj rregulloreje, nëse do të mbaheshin të pabarrësuar, ku do të zbatohet ky faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar;
 - b) kreditë e pabarrësuar me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, duke përjashtuar kreditë për klientët financiarë, të cilat nuk janë më shumë se 90 ditë në vonesë;
 - c) produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar, me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë;
 - d) mallrat (*commodities*) e tregtuara fizikisht, përfshirë arin, por duke përjashtuar derivativët e mallrave (*commodities*);
 - e) ⁴⁸titujt e pabarrësuar me një maturitet të mbetur prej një viti ose më shumë, që nuk janë me probleme dhe që nuk janë klasifikuar si aktive likuide, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.

Neni 46

Faktori i financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 100%

1. Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 100% për aktivet e mëposhtme:
 - a) çdo aktiv i barrësuar me një maturitet të mbetur një vit ose më shumë;
 - b) çdo aktiv tjetër përveç atyre të parashikuara në nenin 39 deri 45 të kësaj rregulloreje, përfshirë kreditë për klientët financiarë që kanë një maturitet kontraktual të mbetur prej një viti ose më shumë, ekspozimet (kreditë) me probleme, zërat që zbriten nga kapitali rregullator dhe aktivet e qëndrueshme.
2. ⁴⁹Bankat zbatojnë faktorin e financimit të qëndrueshëm të kërkuar prej 100% ndaj diferencës, nëse është pozitive, midis shumës së vlerave të drejta për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) me vlerë të drejtë pozitive dhe shumës së vlerave të drejta për të gjitha grupet e netimit (kompensimit) me vlerë të drejtë negative, të llogaritura në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje.

⁴⁸ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁴⁹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

3. ⁵⁰Bankat, për llogaritjen e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, zbatojnë rregullat e mëposhtme:
- a) marzhi i luhatshmërisë (*variation margin*) i marrë nga bankat prej kundërpartive të tyre, do të zbritet nga vlera e drejtë e një grupi netimi (kompensimi) me vlerë të drejtë pozitive, kur kolaterali i marrë si marzh luhatshmërie (*variation margin*) njihet si aktiv i nivelit 1 në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet dhe kur bankat kanë të drejtën ligjore dhe aftësinë operationale për ta ripërdorur atë kolateral;
 - b) i gjithë marzhi i luhatshmërisë (*variation margin*) i vendosur nga bankat me kundërpartitë e tyre, do të zbritet nga vlera e drejtë e një grupi netimi (kompensimi) me vlerë të drejtë negative.

KREU IX KËRKESA MBIKËQYRËSE

Neni 47 Kërkesa raportuese

1. Bankat raportojnë mbi baza tremujore në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendrike pas mbylljes së periudhës raportuese, raportin neto të financimit të qëndrueshëm, mbi baza individuale, të llogaritur në total, në monedhën raportuese, ⁵¹si dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, sipas formularëve të Aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
2. Bankat, për qëllime monitorimi nga ana e Bankës së Shqipërisë, raportojnë mbi baza tremujore sipas kërkesave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, edhe raportin neto të financimit të qëndrueshëm për monedhën vendase (lek) dhe për secilën prej monedhave të huaja të rëndësishme, ⁵²sipas formularëve të Aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
3. Bankat raportojnë mbi baza tremujore në Bankën e Shqipërisë, Departamenti i Mbikëqyrjes, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendrike pas mbylljes së periudhës raportuese, raportin neto të financimit të qëndrueshëm, mbi baza të konsoliduara, të llogaritur në total, në monedhën raportuese, ⁵³si dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, sipas formularëve të Aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 48 Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.

⁵⁰ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵¹ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵² Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵³ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 49⁵⁴
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 janar 2023, me përjashtimet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni.
2. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, raportojnë mbi baza tremujore në Bankën e Shqipërisë, raportin neto të financimit të qëndrueshëm mbi baza individuale, të llogaritur në total, në monedhën raportuese, si dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, duke filluar nga muaji mars 2022.
3. Bankat, në përjashtim të kërkesës së parashikuar në pikën 2 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, për raportin minimal neto të financimit të qëndrueshëm për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, respektojnë kufijtë dhe afatet e mëposhtme:
 - a) të paktën 70% (duke filluar nga 1 janari 2023);
 - b) të paktën 80% (duke filluar nga 1 janari 2024); dhe
 - c) të paktën 100% (duke filluar nga 1 janari 2025).
4. Bankat, për raportin neto të financimit të qëndrueshëm, për totalin dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme, mbi baza të konsoliduara, respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje, duke filluar nga 1 janari 2024.

Neni 50⁵⁵
Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent SEJKO

⁵⁴ Ndryshuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁵⁵ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

RAPORTIMI MBI RAPORTIN NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM

Numri i formularit	Kodi i formularit	Emërtimi i Formularit
		RAPORTI NETO I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM
1	F1	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR
2	F2	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM
		RAPORTI NETO I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM I THJESHTUAR
3	F3	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR I THJESHTUAR
4	F4	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM I THJESHTUAR
		PËRMBLEDHJE E RAPORTIT NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM
5	F5	PËRMBLEDHJE E RAPORTIT NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM

⁵⁶ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

FORMULARI F1 - FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR

Monedha

			Vlera				Faktori standard i financimit të qëndrueshëm të kërkuar				Faktori i zbatuar i financimit të qëndrueshëm të kërkuar				Financimi i qëndrueshëm i kërkuar
			Aktive jollkuide sipas maturitetit			Aktive likuide	Aktive jollkuide sipas maturitetit			Aktive likuide	Aktive jollkuide sipas maturitetit			Aktive likuide	
			< se 6 muaj	≥ 6 muaj deri < se 1 vit	≥ se 1 vit		< se 6 muaj	≥ 6 muaj deri < se 1 vit	≥ se 1 vit		< se 6 muaj	≥ 6 muaj deri < se 1 vit	≥ se 1 vit		
Rreshti	KODI	Zëri	0010	0020	0030	0040	0050	0060	0070	0080	0090	0100	0110	0120	0130
0010	1	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR													0.00
0020	1.1	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e bankës qendrore													0.00
0030	1.1.1	arka, rezervat dhe ekspozime likuide në bankën qendrore													0.00
0040	1.1.1.1	të pabarësuarua ose të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj					0%	0%	0%	0%					0.00
0050	1.1.1.2	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit					50%	50%	50%	50%					0.00
0060	1.1.1.3	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë					100%	100%	100%	100%					0.00
0070	1.1.2	ekspozime të tjera jollkuide ndaj bankës qendrore					0%	50%	100%						0.00
0080	1.2	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet likuide													0.00
0090	1.2.1	aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 0% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)													0.00
0100	1.2.1.1	të pabarësuarua ose të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj								0%					0.00
0110	1.2.1.2	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit								50%					0.00
0120	1.2.1.3	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë								100%					0.00
0130	1.2.2	aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 10% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)													0.00
0140	1.2.2.1	të pabarësuarua ose të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj								10%					0.00
0150	1.2.2.2	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit								50%					0.00
0160	1.2.2.3	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë								100%					0.00
0170	1.2.3	aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 15% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)													0.00
0180	1.2.3.1	të pabarësuarua ose të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj								15%					0.00
0190	1.2.3.2	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit								50%					0.00
0200	1.2.3.3	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë								100%					0.00
0210	1.2.4	aktivet e nivelit 2A të klasifikuara për 15% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)													0.00
0220	1.2.4.1	të pabarësuarua ose të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj								15%					0.00
0230	1.2.4.2	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit								50%					0.00
0240	1.2.4.3	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë								100%					0.00
0250	1.2.5	aktivet e nivelit 2B të klasifikuara për 50% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)													0.00
0260	1.2.5.1	të pabarësuarua ose të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit								50%					0.00
0270	1.2.5.2	të barrësuarua për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë								100%					0.00
0280	1.3	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga titujt, përveç aktiveve likuide													0.00
0290	1.3.1	tituj jo likuidë													0.00
0300	1.3.1.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit					50%	50%	85%						0.00
0310	1.3.1.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë					100%	100%	100%						0.00

0320	1.4	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kreditë												0.00
0330	1.4.1	depozitat operacionale				50%	50%	100%						0.00
0340	1.4.2	transaksionet e financimit nëpërmjet títujve me klientë financiarë												0.00
0350	1.4.2.1	të garantuara me aktive të nivelit 1												0.00
0360	1.4.2.1.1	të pabarrësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj				0%	50%	100%						0.00
0370	1.4.2.1.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit				50%	50%	100%						0.00
0380	1.4.2.1.3	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë				100%	100%	100%						0.00
0390	1.4.2.2	të garantuara nga aktive të tjera												0.00
0400	1.4.2.2.1	të pabarrësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj				5%	50%	100%						0.00
0410	1.4.2.2.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit				50%	50%	100%						0.00
0420	1.4.2.2.3	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë				100%	100%	100%						0.00
0430	1.4.3	hua dhe paradhënie të tjera ndaj klientëve financiarë				10%	50%	100%						0.00
0440	1.4.4	kredi për klientët jofinanciarë, me përjashtim të bankave qendrore, të cilave u është caktuar një peshë rreziku prej 35% ose më pak												0.00
0450	1.4.4.1	të pabarrësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj				50%	50%	65%						0.00
0460	1.4.4.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit				50%	50%	65%						0.00
0470	1.4.4.3	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë				100%	100%	100%						0.00
0480	1.4.5	kredi të tjera ndaj klientëve jofinanciarë, me përjashtim të bankave qendrore												0.00
0490	1.4.5.0.1	prej të cilave, kredi të siguruara me kolateral pasuri të pajtueshme rezidenciale												0.00
0500	1.4.5.1	të pabarrësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit				50%	50%	85%						0.00
0510	1.4.5.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë				100%	100%	100%						0.00
0520	1.4.6	produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar				10%	50%	85%						0.00
0530	1.5	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial												0.00
0540	1.6	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga derivativët												0.00
0550	1.6.1	financimi i qëndrueshëm i kërkuar për pasivet e derivativëve				5%								0.00
0560	1.6.2	financimi i qëndrueshëm i kërkuar për aktivet e derivativëve				100%								0.00
0570	1.6.3	marzhi fillestar i vendosur				85%	85%	85%	85%					0.00
0580	1.7	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kontributet në fondin e garancisë së një kundërparte qendrore				85%	85%	85%	85%					0.00
0590	1.8	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e tjera												0.00
0600	1.8.1	mallra (commodities) të tregtuara fizikisht												0.00
0610	1.8.1.1	të pabarrësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit						85%						0.00
0620	1.8.1.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë						100%						0.00
0630	1.8.2	shumat e arkëtueshme sipas datës së tregtimit				0%								0.00
0640	1.8.3	aktivet me probleme				100%	100%	100%						0.00
0650	1.8.4	aktivet e tjera				50%	50%	100%						0.00
0660	1.9	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga zërat jashtë bilancit												0.00
0670	1.9.1	lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte brenda grupit, subjekt i trajtimit preferencial												0.00
0680	1.9.2	lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte				5%	5%	5%						0.00
0690	1.9.3	zërat jashtë bilancit të financimit tregtar				5%	7.5%	10%						0.00
0700	1.9.4	zërat jashtë bilancit me probleme				100%	100%	100%						0.00

FORMULARI F2 - FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM

Monedha												
Rreshti	KODI	Zëri	Vlera			Faktori standard i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm			Faktori i zbatuar i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm			Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm
			< se 6 muaj	≥ 6 muaj deri < se 1 vit	≥ se 1 vit	< se 6 muaj	≥ 6 muaj deri < se 1 vit	≥ se 1 vit	< se 6 muaj	≥ 6 muaj deri < se 1 vit	≥ se 1 vit	Totali
			0010	0020	0030	0040	0050	0060	0070	0080	0090	0100
0010	2	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM										0
0020	2.1	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga zërat dhe instrumentet e kapitalit										0
0030	2.1.1	Kapitali bazë i nivelit të parë						100%				0
0040	2.1.2	Kapitali shtesë i nivelit të parë				0%	0%	100%				0
0050	2.1.3	Kapitali i nivelit të dytë				0%	0%	100%				0
0060	2.1.4	Instrumente të tjerë të kapitalit				0%	0%	100%				0
0070	2.2	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat me pakicë										0
0080	2.2.0.1	nga të cilat, obligacione me pakicë										0
0090	2.2.1	Depozita të qëndrueshme me pakicë				95%	95%	100%				0
0100	2.2.0.2	nga të cilat, me penalitet të konsiderueshëm për tërheqje të parakohshme						100%				0
0110	2.2.2	Depozita të tjera me pakicë				90%	90%	100%				0
0120	2.2.0.3	nga të cilat, me penalitet të konsiderueshëm për tërheqje të parakohshme						100%				0
0130	2.3	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientët të tjerë jofinanciarë (përveç bankave qendrore)										0
0140	2.3.0.1	nga të cilat, transaksione të financimit nëpërmjet tikujeve										0
0150	2.3.0.2	nga të cilat, financim i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat operacionale										0
0160	2.3.1	Detyrimet e ofruara nga qeveria shqiptare ose qeveria qendrore e një vendi të huaj				50%	50%	100%				0
0170	2.3.2	Detyrimet e ofruara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale shqiptare ose të një vendi të huaj				50%	50%	100%				0
0180	2.3.3	Detyrimet e ofruara nga njësitë e sektorit publik shqiptar ose të një vendi të huaj				50%	50%	100%				0
0190	2.3.4	Detyrimet e ofruara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare				50%	50%	100%				0
0200	2.3.5	Detyrimet e ofruara nga klientë korporata jofinanciare				50%	50%	100%				0
0210	2.3.6	Detyrimet e ofruara nga shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet, kompanitë e investimeve personale ose ndërmjetës depozitash				50%	50%	100%				0
0220	2.4	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrime ose lehtësi të paravokueshme ose të anulueshme me kushte brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial										0
0230	2.5	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientët financiarë dhe bankat qendrore										0
0240	2.5.1	Detyrimet e ofruara nga Banka e Shqipërisë				0%	50%	100%				0
0250	2.5.2	Detyrimet e ofruara nga banka qendrore e një vendi të huaj				0%	50%	100%				0
0260	2.5.3	Detyrimet e ofruara nga klientët financiarë										0
0270	2.5.3.1	Depozitat operacionale				50%	50%	100%				0
0280	2.5.3.2	Teprica e depozitave operacionale				0%	50%	100%				0
0290	2.5.3.3	Detyrime të tjera				0%	50%	100%				0
0300	2.6	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e ofruara, ku kundërpartia nuk mund të përcaktohet				0%	50%	100%				0
0310	2.7	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet neto të derivativëve				0%	0%	0%				
0320	2.8	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e tjera										0
0330	2.8.1	Detyrimet për t'u paguar sipas datës së tregtimit				0%	0%	0%				
0340	2.8.2	Detyrimet tatimore të shtyra				0%	50%	100%				0
0350	2.8.3	Interesat e pakicës				0%	50%	100%				0
0360	2.8.4	Detyrime të tjera				0%	50%	100%				0

FORMULARI F3 - FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR I THJESHTUAR

Monedha

			Vlera		Faktori standard i financimit të qëndrueshëm të kërkuar			Faktori i zbatuar i financimit të qëndrueshëm të kërkuar			Financimi i qëndrueshëm i kërkuar	
			Aktive jolikuide sipas maturitetit		Aktive likuide	Aktive jolikuide sipas maturitetit		Aktive likuide	Aktive jolikuide sipas maturitetit			Aktive likuide
			< se 1 vit	≥ se 1 vit		< se 1 vit	≥ se 1 vit		< se 1 vit	≥ se 1 vit		
Rreshti	KODI	Zëri	0010	0020	0030	0040	0050	0060	0070	0080	0090	0100
0010	1	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR										0
0020	1.1	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e bankës qendrore										0
0030	1.1.1	arka, rezerva dhe ekspozime likuide në bankën qendrore				0%	0%	0%				0
0040	1.1.2	ekspozime të tjera jolikuide ndaj bankës qendrore				0%	100%					0
0050	1.2	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet likuide										0
0060	1.2.1	aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 0% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)										0
0070	1.2.1.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj						0%				0
0080	1.2.1.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit						50%				0
0090	1.2.1.3	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë						100%				0
0100	1.2.2	aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 10% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)										0
0110	1.2.2.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj						10%				0
0120	1.2.2.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit						50%				0
0130	1.2.2.3	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë						100%				0
0140	1.2.3	aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 15% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)										0
0150	1.2.3.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj						20%				0
0160	1.2.3.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit						50%				0
0170	1.2.3.3	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë						100%				0
0180	1.2.4	aktivet e nivelit 2A të klasifikuara për 15% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)										0
0190	1.2.4.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj						20%				0
0200	1.2.4.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit						50%				0
0210	1.2.4.3	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë						100%				0
0220	1.2.5	aktivet e nivelit 2B të klasifikuara për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)										0
0230	1.2.5.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit						55%				0
0240	1.2.5.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë						100%				0
0250	1.3	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga titujt, përveç aktiveve likuide										0
0260	1.3.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit				50%	85%					0
0270	1.3.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë				100%	100%					0
0280	1.4	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kreditë										0
0290	1.4.1	kredi për klientët jo-financiarë										0
0300	1.4.1.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit				50%	85%					0
0310	1.4.1.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë				100%	100%					0
0320	1.4.2	kredi për klientët financiarë										0
0330	1.4.2.1	të pabarësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit				50%	100%					0
0340	1.4.2.2	të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë				100%	100%					0
0350	1.4.3	produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar				50%	85%					0
0360	1.5	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial										0
0370	1.6	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga derivativët										0
0380	1.6.1	financimi i qëndrueshëm i kërkuar për pasivet e derivativëve				5%						0
0390	1.6.2	financimi i qëndrueshëm i kërkuar për aktivet e derivativëve				100%						0
0400	1.6.3	marzhi fillestar i vendosur				85%	85%	85%				0
0410	1.7	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kontributet në fondin e garancisë së një kundërparte qendrore										0
0420	1.8	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e tjera				100%	100%					0
0430	1.9	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga zërat jashtë bilancit										0
0440	1.9.1	lehtësi e përvokueshme ose të anulueshme me kushte brenda grupit, subjekt i trajtimit preferencial										0
0450	1.9.2	lehtësi e përvokueshme ose të anulueshme me kushte				5%	5%					0
0460	1.9.3	zërat jashtë bilancit të financimit tregtar				10%	10%					0
0470	1.9.4	zërat jashtë bilancit me probleme				100%	100%					0

FORMULARI F4 - FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM I THJESHTUAR

Monedha

Rreshti	KODI	Zëri	Vlera		Faktori standard i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm		Faktori i zbatuar i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm		Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm në total
			< se 1 vit	≥ se 1 vit	< se 1 vit	≥ se 1 vit	< se 1 vit	≥ se 1 vit	
			0010	0020	0030	0040	0050	0060	0070
0010	2	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM							0
0020	2.1	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga zërat dhe instrumentet e kapitalit			0%	100%			0
0030	2.2	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat me pakicë							0
0040	2.2.1	Depozita të qëndrueshme me pakicë			95%	100%			0
0050	2.2.2	Depozita të tjera me pakicë			90%	100%			0
0060	2.3	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientë të tjerë jofinanciarë (përveç bankave qendrore)			50%	100%			0
0070	2.4	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat operationale			50%	100%			0
0080	2.5	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrime ose lehtësi të paravokueshme ose të anulueshme me kushte brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial							0
0090	2.6	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientët financiarë dhe bankat qendrore			0%	100%			0
0100	2.7	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e ofruara, ku kundërpartia nuk mund të përcaktohet			0%	100%			0
0110	2.8	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e tjera			0%	100%			0

FORMULARI F5 - PËRMBLEDHJE E RAPORTIT NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM

Monedha

Rreshti	KODI	Zëri	Vlera	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm	Raporti
			0010	0020	0030	0040
0010	1	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR	0.00	0.00		
0020	1.1	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e bankës qendrore	0.00	0.00		
0030	1.2	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet likuide	0.00	0.00		
0040	1.3	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga titujt, përveç aktiveve likuide	0.00	0.00		
0050	1.4	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kreditë	0.00	0.00		
0060	1.5	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial	0.00	0.00		
0070	1.6	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga derivativët	0.00	0.00		
0080	1.7	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kontributet në fondin e garancisë së një kundërpattie qendrore	0.00	0.00		
0090	1.8	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e tjera	0.00	0.00		
0100	1.9	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga zërat jashtë bilancit	0.00	0.00		
0110	2	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM	0.00		0.00	
0120	2.1	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga zërat dhe instrumentet e kapitalit	0.00		0.00	
0130	2.2	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat me pakicë	0.00		0.00	
0140	2.3	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientë jofinanciarë (përveç bankave qendrore)	0.00		0.00	
0150	2.4	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat operacionale	0.00		0.00	
0160	2.5	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrime ose lehtësi të parevokueshme ose të anulueshme me kushte brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial	0.00		0.00	
0170	2.6	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientët financiarë dhe bankat qendrore	0.00		0.00	
0180	2.7	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e ofruara, ku kundërpartia nuk mund të përcaktohet	0.00		0.00	
0190	2.8	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e tjera	0.00		0.00	
0200	3	RAPORTI NETO I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM				#DIV/0!

FORMULARI F5 - PËRMBLEDHJE E RAPORTIT NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM I THJESHTUAR

Monedha

Rreshti	KODI	Zëri	Vlera	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm	Raporti
			0010	0020	0030	0040
0010	1	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR	0.00	0.00		
0020	1.1	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e bankës qendrore	0.00	0.00		
0030	1.2	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet likuide	0.00	0.00		
0040	1.3	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga titujt, përveç aktiveve likuide	0.00	0.00		
0050	1.4	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kreditë	0.00	0.00		
0060	1.5	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial	0.00	0.00		
0070	1.6	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga derivativët	0.00	0.00		
0080	1.7	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kontributet në fondin e garancisë së një kundërpattie qendrore	0.00	0.00		
0090	1.8	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e tjera	0.00	0.00		
0100	1.9	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga zërat jashtë bilancit	0.00	0.00		
0110	2	FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM	0.00		0.00	
0120	2.1	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga zërat dhe instrumentet e kapitalit	0.00		0.00	
0130	2.2	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat me pakicë	0.00		0.00	
0140	2.3	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientë jofinanciarë (përveç bankave qendrore)	0.00		0.00	
0150	2.4	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat operationale	0.00		0.00	
0160	2.5	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrime ose lehtësi të parevokueshme ose të anulueshme me kushte brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial	0.00		0.00	
0170	2.6	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientët financiarë dhe bankat qendrore	0.00		0.00	
0180	2.7	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e ofruara, ku kundërpartia nuk mund të përcaktohet	0.00		0.00	
0190	2.8	Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e tjera	0.00		0.00	
0200	3	RAPORTI NETO I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM I THJESHTUAR				#DIV/0!

UDHËZUES SHPJEGUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARËVE TË ANEKSIT 1
RAPORTIMI MBI RAPORTIN NETO TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM TË BANKAVE

Përmbajtja e tabelës

PJESA I: UDHËZIME TË PËRGJITHSHME.....	38
PJESA II: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR (FQK).....	39
1. Shënime specifike.....	39
1.1 Udhëzime për kolonat specifike.....	40
1.2 Udhëzime për rreshtat specifike.....	41
PJESA III: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM (FQD)	52
1. Shënime specifike.....	52
1.1 Udhëzime lidhur me kolonat specifike.....	53
1.2 Udhëzime lidhur me rreshtat specifike.....	54
PJESA IV: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR I THJESHTUAR	61
1. Shënime specifike.....	61
1.2 Udhëzime për kolonat specifike.....	62
1.2 Udhëzime për rreshtat specifike.....	63
PJESA V: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM I THJESHTUAR.....	70
1. Shënime specifike.....	70
1.1 Udhëzime për kolonat specifike.....	71
1.2 Udhëzime për rreshtat specifike	72
PJESA VI: RAPORTI NETO I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM - PËRMBLEDHJE	
.....	77
1. Shënime specifike.....	77
1.1 Udhëzime për kolonat specifike.....	77
1.2 Udhëzime për rreshtat specifike	78

⁵⁷ Shtuar me vendimin nr.45, datë 1.9.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

PJESA I: UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

1. Ky aneks përmban udhëzime për plotësimin e formularëve për përlogaritjen e raportit neto të financimit të qëndrueshëm, si dhe informacion mbi zërat e financimit të qëndrueshëm të kërkuar dhe të disponueshëm, për qëllime të raportimit të raportit neto të financimit të qëndrueshëm të bankave, siç përcaktohet në këtë rregullore. Qelizat që nuk duhet të plotësohen nga bankat janë shënuar me ngjyrë gri.
2. Bankat i raportojnë formularët e Aneksit 1 në monedhën raportuese, pavarësisht monedhës së denominimit të aktiveve, pasiveve dhe zërave jashtë bilancit, si dhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme. Bankat gjithashtu, për qëllime monitorimi, raportojnë formularët e Aneksit 1 edhe për monedhën vendase (Lek) dhe për secilën prej monedhave të huaja të rëndësishme, siç përcaktohet në nenin 47 të kësaj rregulloreje.
3. Në lidhje me llogaritjen e raportit neto të financimit të qëndrueshëm të bankave, rregullorja u referohet faktorëve të financimit të qëndrueshëm. Fjala “faktor” në kontekstin e këtyre udhëzimeve i referohet një numri midis 0 dhe 1, i cili, pasi shumëzohet me vlerën, paraqet vlerën e ponderuar siç parashikohet në nenin 6 të rregullores.
4. Me qëllim shmangien e llogaritjes së dyfishtë, bankat nuk duhet të raportojnë aktivet ose pasivet që janë të lidhura me kolateralin e vendosur ose të marrë në formën e marzhit të luhatshmërisë (*variation margin*) në përputhje me nenin 12, pika 5, dhe me nenin 28, pika 3, të rregullores, marzhit fillestar për kontratat e derivativëve dhe kontributit në fondin e garancisë së një kundërpartie qendrore, në përputhje me shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 27 të rregullores.
5. Zërat që janë dhënë apo marrë nga banka brenda grupit, në rastet kur Banka e Shqipërisë ka lejuar zbatimin e një trajtimi preferencial sipas nenit 9 të rregullores, duhet të raportohen në një kategori të veçantë.
6. Për qëllime të raportimit, në kolonat e emërtuara “Vlera”, bankat duhet të raportojnë në çdo rast vlerën kontabël, me përjashtim të rasteve të kontratave të derivativëve, për të cilat bankat duhet t’i referohen vlerës së drejtë të parashikuar në nenin 7, pika 2, të rregullores.
7. Për qëllime të raportimit sipas monedhës, në përputhje me nenin 47 të rregullores, që u referohet kontratave të derivativëve të parashikuar në nenin 7, pika 3, të rregullores, bankat duhet të llogarisin vlerën e drejtë për çdo grup netimi në monedhën e shlyerjes. Për të gjitha grupet e netimit në monedha të njëjta, një vlerë neto duhet të llogaritet në përputhje me nenin 12, pika 4 dhe nenin 28, pika 2 të rregullores, të raportuara në monedhën përkatëse. Në këtë kontekst, monedha e shlyerjes nënkupton monedhën në të cilën është dakorduar shlyerja e grupit të netimit. Grupi i netimit i referohet grupit të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme që rrjedhin nga transaksionet e derivativëve me një kundërparti, pavarësisht nëse janë të denominuar në një monedhë të ndryshme nga monedha e shlyerjes. Në rastin e mundësive të përdorimit të disa monedhave, banka duhet të kryejë një vlerësim të monedhës në të cilën shlyerja ka më tepër mundësi për të ndodhur dhe duhet ta raportojë vetëm në atë monedhë.
8. Vlera e aktiveve dhe pasiveve që rezultojnë nga transaksionet e financimit nëpërmjet titujve me një kundërparti të vetme dhe të njëjtin lloj kolaterali bazë (aktive likuide të nivelit 1 ose aktive likuide jo të nivelit 1, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet), duhet të raportohet në baza neto, kur zbatohet neni 8 i rregullores. Në rastin e transaksioneve të financimit nëpërmjet titujve me disa (një shportë) kolaterale bazë, kolaterali më pak likuid duhet të nënkuptohet si kolaterali i parë i lënë peng.

9. Në përputhje me nenin 29 të rregullores, bankat me rëndësi josistemike mund të zgjedhin të llogarisin raportin neto të financimit të qëndrueshëm sipas metodologjisë së thjeshtuar të paraqitur në Kreun VII dhe Kreun VIII të rregullores. Bankat që përdorin këtë metodologji të thjeshtuar për llogaritjen e raportit neto të financimit të qëndrueshëm duhet të përdorin formularët e raportimit F3 dhe F4 të Aneksit 1. Të gjitha bankat e tjera duhet të përdorin formularët F1 dhe F2. Pavarësisht nga metodologjia e zbatuar, të gjitha bankat duhet të raportojnë formularin F5.

PJESA II: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR (FQK)

1. Shënime specifike

10. Bankat raportojnë në kategorinë përkatëse të gjitha aktivet për të cilat zotërojnë pronësinë, edhe nëse nuk mbahen në bilancin e bankës. Aktivet mbi të cilat bankat nuk zotërojnë pronësinë, nuk duhet të raportohen, edhe nëse aktivet mbahen në bilancin e bankës. Në rast të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, ku aktivet e marra hua nuk mbahen në bilancin e bankës, por banka që i ka marrë zotëron pronësinë e tyre, duhet të raportohet pozicioni në *cash (the cash leg)* ose pozicioni në kolateral (*the collateral leg*), nëse zbatohet një faktor më i lartë i financimit të qëndrueshëm të kërkuar (FQK).
11. Në përputhje me nenin 17 të rregullores, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në Kreun V, shuma e financimit të qëndrueshëm të kërkuar llogaritet duke shumëzuar vlerën e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit me faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar.
12. Aktivet që kualifikohen si aktive likuide në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, raportohen si të tilla, pavarësisht nëse plotësojnë ose jo kërkesat operationale të parashikuara në atë rregullore. Këto aktive raportohen në kolonat përkatëse, pavarësisht maturitetit të mbetur.
13. Të gjitha aktivet jolikuide dhe zërat jashtë bilancit raportohen të ndara sipas maturitetit të tyre të mbetur, në përputhje me nenin 18 të rregullores. Shportat e maturitetit për vlerat, për faktorët standardë të financimit të qëndrueshëm të kërkuar dhe për faktorët e zbatueshëm të financimit të qëndrueshëm të kërkuar, janë të ndara si më poshtë:
- i. maturitet i mbetur prej më pak se 6 muaj ose pa maturitet të përcaktuar;
 - ii. maturitet i mbetur prej të paktën 6 muaj, por më pak se 1 vit;
 - iii. maturitet i mbetur prej 1 viti ose më shumë.
14. Në përputhje me nenin 18 pika 2 e rregullores, kur llogaritet maturiteti i mbetur i aktiveve jolikuide dhe zërave jashtë bilancit, bankat marrin në konsideratë edhe opsionet, bazuar në supozimin se emetuesi ose kundërpartia do të ushtrojë çdo opsion për të zgjatur maturitetin e aktiveve. Për opsionet e ushtruara në diskrecionin e bankës, banka duhet të marrë në konsideratë faktorët reputacionalë që mund të kufizojnë aftësinë e saj për të mos ushtruar opsionin, në veçanti duke konsideruar pritshmëritë e tregjeve dhe klientëve që banka duhet të zgjasë maturitetin e aktiveve të caktuara në datën e maturimit të tyre.
15. Për disa zëra, bankat duhet t'i raportojnë aktivet sipas statusit dhe/ose maturimit të barrësimit të aktivit të caktuar, në përputhje me pikat 4-7 të nenit 17 të rregullores.

16. Siç përcaktohet në nenin 17 pika 6 të rregullores, në rastet kur banka ripërdor apo rivendos peng një aktiv të marrë hua, përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, dhe nëse ky aktiv mbahet si zë jashtë bilancit, transaksioni nëpërmjet të cilit aktivet janë marrë hua, do të trajtohet si i barrësuar, me kusht që ky transaksion nuk mund të maturohet nëse banka nuk e ka kthyer aktivin e marrë hua. Si maturiteti i mbetur i barrësimit do të konsiderohet vlera më e lartë ndërmjet: *i)* maturitetit të mbetur të transaksionit nëpërmjet të cilit aktivet u morën hua; dhe *ii)* maturitetit të mbetur të transaksionit ku aktivet u rivendosën peng.

1.1 Udhëzime për kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010-0030	<u>Vlera e aktiveve jolikuide</u> Bankat raportojnë në kolonat 0010-0030, vlerën e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të referuara në nënkreun II të kreut V të rregullores për çdo kategori maturitetesh, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në kreun V të rregullores. Vlera do të raportohet në kolonat 0010-0030 kur zëri përkatës nuk njihet si aktiv likuid në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operacionale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërpërmendur.
0040	<u>Vlera e aktiveve likuide</u> <i>Referojuni udhëzimeve në kolonat 0010-0030.</i> Vlera do të raportohet në kolonën 0040 kur zëri përkatës është klasifikuar si aktiv likuid, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operacionale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërpërmendur.
0050-0080	<u>Faktori standard i financimit të qëndrueshëm të kërkuar</u> <i>Nënkreu II i kreut V të rregullores</i> Faktorët standardë në kolonat 0050-0080 janë ata faktorë të përcaktuar në kreun V të rregullores, që do të përcaktojnë atë pjesë të vlerës së aktiveve dhe zërave jashtë bilancit, që përbën financimin e qëndrueshëm të kërkuar. Faktorët standardë në kolonat 0050-0080 paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk duhet të plotësohen ose ndryshohen nga bankat.

0090-0120	<u>Faktori i zbatuar i financimit të qëndrueshëm të kërkuar</u> <i>Nënkreu II i kreut V të rregullores</i> Bankat raportojnë në kolonat 0090-0120 faktorët e zbatuar për zërat e parashikuar në kreun V të rregullores. Faktorët e zbatuar mund të rezultojnë në vlera mesatare të ponderuara dhe duhet të raportohen në numra dhjetorë (d.m.th. 1.00 për një normë të zbatueshme prej 100 për qind, ose 0.50 për një normë të zbatueshme prej 50 për qind). Faktorët e zbatuar mund të reflektojnë, por nuk kufizohen në, karakteristikat specifike të bankës apo të vendit.
0130	<u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar</u> Bankat raportojnë në kolonën 0130 financimin e qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me kreun V të rregullores. Financimi i qëndrueshëm i kërkuar llogaritet sipas formulës së mëposhtme: c 0130= Shuma {(c 0010* c 0090), (c 0020 * c 0100), (c 0030 * c 0110), (c 0040 * c 0120)}

1.2 Udhëzime për rreshtat specifike

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010	1. <u>FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR</u> <i>Kreu V i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht zërat subjekt i financimit të qëndrueshëm të kërkuar, në përputhje me kreun V të rregullores.
0020	1.1 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e bankës qendrore</u> <i>Neni 19, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, dhe neni 25, pika 1, shkronja “d” e rregullores.</i> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet në bankën qendrore.
0030	1.1.1 <u>arka, rezerva dhe ekspozime likuide në bankën qendrore</u> Bankat raportojnë në këtë rresht arkën (paratë <i>cash</i>) dhe rezervat në bankën qendrore, përfshirë edhe tepricën në llogarinë e rezervës së detyruar. Bankat raportojnë në këtë rresht edhe çdo ekspozim tjetër ndaj bankës qendrore që konsiderohet si aktiv likuid në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo

	kërkesat operacionale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërpërmendur. Rezervat e detyrueshme që nuk konsiderohen si aktive likuide në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, duhet të raportohen në kolonën përkatëse të aktiveve jolikuide.
0040	1.1.1.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.1.1 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muaj.
0050	1.1.1.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.1.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj, por më pak se 1 vit.
0060	1.1.1.3 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.1.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0070	1.1.2 <u>ekspozime të tjera jolikuide ndaj bankës qendrore</u> Bankat raportojnë në këtë rresht çdo pretendim tjetër ndaj bankës qendrore, të ndryshëm nga ato të raportuara në seksionin 1.1.1.
0080	1.2 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet likuide</u> <i>Neni 19, pika 1, shkronja "a" deri në nenin 25 të rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet likuide në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operacionale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërpërmendur.
0090	1.2.1 <u>aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 0% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen si aktive likuide të nivelit 1 mbi të cilat zbatohet një haircut prej 0%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0100	1.2.1.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh</u>

	Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.1 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0110	<u>1.2.1.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0120	<u>1.2.1.3 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0130	<u>1.2.2 aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 10% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen si aktive likuide të nivelit 1 mbi të cilat zbatohet një haircut prej 10%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0140	<u>1.2.2.1 të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur më pak se 6 muaj</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.2 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0150	<u>1.2.2.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.2 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0160	<u>1.2.2.3 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.2 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0170	<u>1.2.3 aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 15% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen si aktive likuide të nivelit 1 mbi të cilat zbatohet një haircut prej 15%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me

	likuiditet.
0180	<u>1.2.3.1 të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh</u> Bankat raportojnë në këtë rresht, shumën e raportuar në seksionin 1.2.3 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0190	<u>1.2.3.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.3 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0200	<u>1.2.3.3 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.3 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0210	<u>1.2.4 aktive të nivelit 2A të klasifikuara për 15% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen si aktive të nivelit 2A mbi të cilat zbatohet një haircut prej 15%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0220	<u>1.2.4.1 të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.4 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0230	<u>1.2.4.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.4 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0240	<u>1.2.4.3 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.4 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0250	<u>1.2.5 aktive të nivelit 2B të klasifikuara për 50% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u>

	Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen si aktive të nivelit 2B mbi të cilat zbatohet një <i>haircut</i> prej 50%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0260	1.2.5.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.5 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.
0270	1.2.5.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.5 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0280	1.3 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga titujt, përveç aktiveve likuide</u> <i>Neni 27, pika 1, shkronja “f” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht titujt që nuk janë me probleme dhe që nuk janë klasifikuar si aktive likuide, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operationale të parashikuara në rregulloren e sipërpërmendur.
0290	1.3.1 <u>tituj jolikuidë</u> <i>Neni 27, pika 1, shkronja “f” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.3 që lidhet me tituj jolikuidë.
0300	1.3.1.1 <u>të pabarrësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.3.1 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.
0310	1.3.1.2 <u>të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.3.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0320	1.4 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kreditë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht paratë për t’u marrë nga kreditë që nuk janë me probleme. Siç përcaktohet në nenin 18, pika 3 e rregullores, për kreditë me këste me një maturitet kontraktual të mbetur prej 1 viti ose më shumë, çdo pjesë e kredisë që maturohet në

	më pak se 6 muaj dhe çdo pjesë që maturohet midis 6 muaj dhe më pak se 1 vit, do të trajtohet përkatësisht si kredi me maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh dhe midis 6 muajsh dhe më pak se 1 viti.
0330	1.4.1 <u>depozitat operacionale</u> <i>Neni 25, pika 1, shkronja “b”, dhe neni 28, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4 që lidhet me depozitat e klasifikuara si depozita operacionale, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0340	1.4.2 <u>transaksionet e financimit nëpërmjet titujve me klientë financiarë</u> <i>Neni 8, neni 19, pika 1, shkronja “e”, dhe neni 20, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4 që lidhet me paratë për t’u marrë nga transaksionet e financimit nëpërmjet titujve me klientë financiarë.
0350	1.4.2.1 <u>të garantuara me aktive të nivelit 1</u> <i>Neni 19, pika 1, shkronja “e”; neni 25, pika 1, shkronja “d”; dhe neni 28, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2 që lidhet me transaksionet e garantuara (kolateralizuara) me aktive të nivelit 1, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0360	1.4.2.1.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur më pak se 6 muaj</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2.1 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0370	1.4.2.1.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht, shumën e raportuar në seksionin 1.4.2.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0380	1.4.2.1.3 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u>

	Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0390	1.4.2.2 <u>të garantuara nga aktive të tjera</u> <i>Neni 20, pika 1, shkronja “a”; neni 25, pika 1, shkronja “d”; dhe neni 28, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2 që lidhet me aktive që janë të garantuara (kolateralizuara) me aktive të ndryshme nga aktivet e nivelit 1, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0400	1.4.2.2.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2.2 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0410	1.4.2.2.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2.2 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0420	1.4.2.2.3 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2.2 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0430	1.4.3 <u>hua dhe paradhënie të tjera ndaj klientëve financiarë</u> <i>Neni 22, pika 1, shkronja “b” dhe neni 25, pika 1, shkronja “d”, nënpika “iii” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4, që rrjedh nga hua dhe paradhënie të tjera ndaj klientëve financiarë, që nuk është raportuar në seksionet 1.4.1 dhe 1.4.2.
0440	1.4.4 <u>kredi për klientët jofinanciarë, me përjashtim të bankave qendrore, të cilave u është caktuar një peshë rreziku prej 35% ose më pak</u> <i>Neni 25, pika 1, shkronja “c”, dhe neni 26 i rregullores</i>

	Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4 që lidhet me kreditë e siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale, me përjashtim të kredive ndaj klientëve financiarë dhe kredive të referuara në nenet 19 deri në 25 të rregullores, me kusht që këtyre kredive u është caktuar një peshë rreziku prej 35% ose më pak, në përputhje me kreun III të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
0450	1.4.4.1 të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.4 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0460	1.4.4.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.4 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0470	1.4.4.3 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.4 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0480	1.4.5 kredi të tjera ndaj klientëve jofinanciarë, me përjashtim të bankave qendrore <i>Neni 25, pika 1, shkronja “c”, dhe neni 27, pika 1, shkronja “c” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën që lidhet me kredi ndaj klientëve jofinanciarë, me përjashtim të bankave qendrore, të cilave u është caktuar një peshë rreziku prej më shumë se 35%, në përputhje me kreun III të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
0490	1.4.5.0.1 prej të cilave, kredi të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.5 që lidhet me ekspozimet e siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme rezidenciale.
0500	1.4.5.1 të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.5 që lidhet me aktivet e pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.

0510	<u>1.4.5.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.5 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0520	<u>1.4.6 produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar</u> <i>Neni 22, pika 1, shkronja “c”; neni 25, pika 1, shkronja “e”; dhe neni 27, pika 1, shkronja “d” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e lidhur me produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar.
0530	<u>1.5 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial</u> <i>Neni 9 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet e lejuara nga Banka e Shqipërisë për trajtimin preferencial, në përputhje me nenin 9 të rregullores.
0540	<u>1.6 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga derivativët</u> <i>Neni 7, neni 20, pika 2; neni 27, pika 1, shkronja “a”; dhe neni 28, pika 2 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar që krijohet nga derivativët.
0550	<u>1.6.1 financimi i qëndrueshëm i kërkuar për pasivet e derivativëve</u> <i>Neni 20, pika 2 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.6, e cila është vlera e drejtë absolute e grupit të netimit (kompensimit) me një vlerë të drejtë negative, të llogaritur në përputhje me nenin 20, pikat 1 dhe 2 të rregullores.
0560	<u>1.6.2 financimi i qëndrueshëm i kërkuar për aktivet e derivativëve</u> <i>Neni 7 dhe neni 28, pika 2 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.6, e cila llogaritet si diferenca pozitive midis grupeve të netimit (kompensimit), të llogaritur në përputhje me nenin 28, pika 2 të rregullores.
0570	<u>1.6.3 marzhi fillestar i vendosur</u> <i>Neni 27, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i>

	Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.7 që lidhet me marzhin fillestar të vendosur për kontratat e derivativëve.
0580	1.7 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kontributet në fondin e garancisë së një kundërpattie qendrore</u> <i>Neni 27, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht zërat e vendosur si kontribut në fondin e garancisë së kundërpatisë qendrore.
0590	1.8 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e tjera</u> Bankat raportojnë në këtë rresht çdo lloj aktivi që nuk është raportuar në seksionet 1.1 deri në 1.7.
0600	1.8.1 <u>mallra (commodities) të tregtuara fizikisht</u> <i>Neni 27, pika 1, shkronja “e” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.8 që lidhet me mallrat (commodities) e tregtuara fizikisht. Ky zë nuk përfshin derivativët e mallrave (commodities) që raportohen në seksionin 1.6.
0610	1.8.1.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.8.1 që lidhet me aktivet e pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.
0620	1.8.1.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.8.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0630	1.8.2 <u>shumat e arkëtueshme sipas datës së tregtimit</u> <i>Neni 19, pika 1, shkronja “d” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.8 që lidhet me shumat e arkëtueshme sipas datës së tregtimit.
0640	1.8.3 <u>aktivet me probleme</u> <i>Neni 28, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.8 që lidhet me

	aktivet me probleme.
0650	1.8.4 <u>aktivet e tjera</u> <i>Neni 28, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.8 që lidhet me aktivet që nuk janë raportuar në seksionet 1.8.1 deri në 1.8.3.
0660	1.9 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga zërat jashtë bilancit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e zërave jashtë bilancit që nuk janë raportuar në seksionet 1.1 deri në 1.8, që janë subjekt i kërkesave të financimit të qëndrueshëm të kërkuar.
0670	1.9.1 <u>lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte brenda grupit, subjekt i trajtimit preferencial</u> <i>Neni 9 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.9 që lidhet me lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte, të lejuara nga Banka e Shqipërisë për trajtimin preferencial, në përputhje me nenin 9 të rregullores.
0680	1.9.2 <u>lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte</u> <i>Neni 20, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.9 që lidhet me lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, që nuk janë raportuar në seksionin 1.9.1.
0690	1.9.3 <u>zërat jashtë bilancit të financimit tregtar</u> <i>Neni 20, pika 1, shkronja “c”; neni 21; dhe neni 22, pika 1, shkronja “d” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.9 që lidhet me produktet e lidhura me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar, siç përcaktohen në aneksin 2 të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
0700	1.9.4 <u>zërat jashtë bilancit me probleme</u> <i>Neni 28, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.9 që lidhet me ekspozimet me probleme për zërat jashtë bilancit.

PJESA III: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM (FQD)

1. Shënime specifike

17. Të gjitha detyrimet dhe zërat e kapitalit rregullator duhet të raportohen të klasifikuara sipas maturitetit të mbetur të tyre, në përputhje me nenin 11 të rregullores. Shportat e maturitetit për vlerat, për faktorët standardë të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm dhe për faktorët e zbatueshëm të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, janë të ndara si më poshtë:
- i. maturitet i mbetur prej më pak se 6 muajsh ose pa maturitet të përcaktuar;
 - ii. maturitet i mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit;
 - iii. maturitet i mbetur prej 1 viti ose më shumë.
18. Bankat, për të gjitha pasivet me maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë, zbatojnë një faktor të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 100%, me përjashtim kur specifikohet ndryshe në nenet 12 deri në 15, në përputhje me nenin 16 të rregullores.
19. Të gjitha depozitat pa afat (*sight deposits*) duhet të raportohen në kategorinë e detyrimeve me maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
20. Në përputhje me nenin 11, pika 2, të rregullores, bankat duhet të marrin në konsideratë opsionet ekzistuese për të përcaktuar maturitetin e mbetur të një detyrimi ose të zërave të kapitalit rregullator, duke supozuar se kundërpartia do të ushtrojë opsionet *call* (call options) në datën më të shpejtë të mundshme. Për opsionet që ushtrohen në diskrecionin e bankës, banka merr parasysh faktorët reputacionalë që mund të kufizojnë aftësinë e saj për të mos ushtruar opsionin, në veçanti pritshmëritë e tregut që banka duhet të shlyejë detyrime të caktuara përpara maturitetit të tyre.
21. Gjithashtu, siç përcaktohet në nenin 16 të rregullores, për zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë, zërat e kapitalit të nivelit të dytë dhe instrumentet të tjera të kapitalit me opsione të qarta ose të përfshira (*explicit or embedded options*), të cilat nëse ushtrohen (edhe nëse nuk janë ushtruar ende në datën referencë të raportimit), do të reduktonin maturitetin e mbetur efektiv në datën referencë të raportimit në më pak se 1 vit, nuk duhet të zbatohet një faktor i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 100%.
22. Siç parashikohet në nenin 11, pika 3, të rregullores, bankat trajtojnë depozitat me një periudhë njoftimi të përcaktuar, në përputhje me periudhën e njoftimit të tyre, dhe depozitat me afat, në përputhje me maturitetin e mbetur të tyre. Pa rënë ndesh me paragrafin 20 më sipër, bankat për të përcaktuar maturitetin e mbetur të depozitave me pakicë me afat, nuk marrin parasysh opsionet për tërheqje të parakohshme, kur depozituesi duhet të paguajë një penaltet të konsiderueshëm për tërheqjet e parakohshme të kryera në më pak se 1 vit, penaltet i cili është materialisht më i lartë se humbja e interesit të përllëgoar deri në datën e tërheqjes, siç përcaktohet në pikën 5 të nenit 21 të rregullores së mbulimit me likuiditet.

1.1 Udhëzime lidhur me kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010-0030	<u>Vlera</u> Bankat raportojnë në kolonat 010-030 shumën e detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator, të ndara sipas shportave të maturitetit të mbetur të tyre.
0040-0060	<u>Faktori standard i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm</u> <i>Nënkreu II i kreut IV të rregullores</i> Faktorët standardë në kolonat 0040-0060 janë ata faktorë të përcaktuar në kreun IV të rregullores, që do të përcaktojnë atë pjesë të vlerës së detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator, që përbën financimin e qëndrueshëm të disponueshëm. Faktorët standardë në kolonat 0040-0060 paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk duhet të plotësohen ose ndryshohen nga bankat.
0070-0090	<u>Faktori i zbatuar i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm</u> <i>Kreu IV i rregullores</i> Bankat raportojnë në kolonat 0070-0090 faktorët e zbatuar të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, si pesha që, pasi shumëzohen me detyrimet ose zërat e kapitalit rregullator, do të përcaktojnë shumën përkatëse të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm. Faktorët e zbatuar mund të rezultojnë në vlera mesatare të ponderuara dhe duhet të raportohen në numra dhjetorë (d.m.th. 1.00 për një normë të zbatueshme prej 100 për qind, ose 0.50 për një normë të zbatueshme prej 50 për qind). Faktorët e zbatuar mund të reflektojnë, por nuk kufizohen në, karakteristikat specifike të bankës apo të vendit.
0100	<u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm</u> Bankat raportojnë në kolonën 0100 financimin e qëndrueshëm të disponueshëm, në përputhje me përcaktimet e nenit 10 të rregullores. Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm llogaritet sipas formulës së mëposhtme: $c\ 0100 = \text{Shuma } \{(c\ 0010 * c\ 0070), (c\ 0020 * c\ 0080), (c\ 0030 * c\ 0090)\}$

1.2 Udhëzime lidhur me rreshtat specifike

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010	2. <u>FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM</u> <i>Kreu IV i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht zërat subjekt i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, në përputhje me kreun IV të rregullores.
0020	2.1 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga zërat dhe instrumentet e kapitalit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e zërave nga seksioni 2.1.1 tek seksioni 2.1.4.
0030	2.1.1 <u>Kapitali bazë i nivelit të parë</u> <i>Neni 16, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht kapitalin bazë të nivelit të parë, para aplikimit të filtrave prudencialë, reduktimeve dhe përjashtimeve të parashikuara në nenet 7-11 dhe në nenin 20 të rregullores së kapitalit rregullator.
0040	2.1.2 <u>Kapitali shtesë i nivelit të parë</u> <i>Neni 16, pika 1, shkronja “b”, dhe neni 12, pika 3, shkronja “c” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë, përpara aplikimit të zbritjeve të përcaktuara në nenin 25 të rregullores së kapitalit rregullator.
0050	2.1.3 <u>Kapitali i nivelit të dytë</u> <i>Neni 16, pika 1, shkronja “c” dhe neni 12, pika 3, shkronja “c” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht zërat e kapitalit të nivelit të dytë, përpara aplikimit të zbritjeve të përcaktuara në nenin 33 të rregullores së kapitalit rregullator, të cilët kanë një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë, në datën referencë të raportimit.
0060	2.1.4 <u>Instrumente të tjera të kapitalit</u> <i>Neni 16, pika 1, shkronja “d” dhe neni 12, pika 3, shkronja “c” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht, instrumente të tjera të kapitalit me maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë, në datën referencë të raportimit.

0070	2.2. <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat me pakicë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e zërave në seksionin 2.2.1 dhe 2.2.2. Ky zë përfshin detyrimet e siguruara dhe pasiguruara.
0080	2.2.0.1 <u>nga të cilat, obligacione me pakicë</u> <i>Neni 10 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht obligacionet dhe titujt e borxhit të emetuara nga banka, të cilët janë shitur ekskluzivisht në tregun me pakicë dhe mbahen në llogari me pakicë. Obligacionet me pakicë duhet të raportohen gjithashtu brenda kategorisë përkatëse të depozitave me pakicë, si “depozita të qëndrueshme me pakicë” ose “depozita të tjera me pakicë”, sipas seksioneve 2.2.1 dhe 2.2.2.
0090	2.2.1 <u>Depozita të qëndrueshme me pakicë</u> <i>Neni 15 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht pjesën e depozitave me pakicë të siguruar nga skema e sigurimit të depozitave siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja, e cila është pjesë e një marrëdhënieje të krijuar më parë (<i>established relationship</i>) me bankën, gjë që e bën pothuajse të pamundur tërheqjen e depozitës; ose mbahet në formën e një llogarie rrjedhëse (transaksionesh), përkatësisht në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 20 të rregullores së mbulimit me likuiditet, dhe kur: • këto depozita nuk përmbushin kriteret për një normë më të lartë të flukseve dalëse në përputhje me pikat 2, 3 dhe 9 të nenit 21 të rregullores së mbulimit me likuiditet, ku do të raportohen si “depozita të tjera me pakicë”; ose • këto depozita nuk janë marrë në vendet e huaja ku aplikohet një normë e lartë e flukseve dalëse, në përputhje me nenin 21, pika 5, të rregullores së mbulimit me likuiditet, ku do të raportohen si “depozita të tjera me pakicë”.
0100	2.2.0.2 <u>nga të cilat, me penalitet të konsiderueshëm për tërheqje të parakohshme</u> <i>Neni 11, pika 3 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht depozitat e qëndrueshme me pakicë që mund të tërhiqen përpara 1 viti, kundrejt pagesës së penalitetit që vlerësohet si i konsiderueshëm, në përputhje me pikën 5 të nenit 21 të rregullores së mbulimit me likuiditet.
0110	2.2.2 <u>Depozita të tjera me pakicë</u> <i>Neni 14 i rregullores</i>

	Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e depozitave të tjera me pakicë, përveç atyre të përcaktuara si “depozita të qëndrueshme me pakicë” në seksionin 2.2.1.
0120	<u>2.2.0.3 nga të cilat, me penalitet të konsiderueshëm për tërheqje të parakohshme</u> Bankat raportojnë në këtë rresht depozita të tjera me pakicë që mund të tërhiqen përpara 1 viti, kundrejt pagesës së penalitetit që vlerësohet si i konsiderueshëm, në përputhje me pikën 5 të nenit 21 të rregullores së mbulimit me likuiditet.
0130	<u>2.3 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientë të tjerë jofinanciarë (përveç bankave qendrore)</u> <i>Neni 13 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet e ofruara nga klientë jofinanciarë me shumicë (përveç bankave qendrore). Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e zërave nga seksioni 2.3.1 në seksionin 2.3.6.
0140	<u>2.3.0.1 nga të cilat, transaksione të financimit nëpërmjet titujve</u> <i>Neni 8, neni 19, pika 1, shkronja “e” dhe neni 20, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 2.3 që lidhet me paratë për t’u marrë nga transaksionet e financimit nëpërmjet titujve me klientë jofinanciarë.
0150	<u>2.3.0.2 nga të cilat, financim i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat operacionale</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 2.3 që sigurohet në formën e depozitave operacionale dhe që kërkohet për ofrimin e shërbimeve operacionale të parashikuara në nenin 22 të rregullores së mbulimit me likuiditet.
0160	<u>2.3.1 Detyrimet e ofruara nga Qeveria Shqiptare ose qeveria qendrore e një vendi të huaj</u> <i>Neni 13, pika 1, shkronja “b”, nënpika “i” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 2.3 që ofrohet nga Qeveria Shqiptare ose nga qeveria qendrore e një vendi të huaj.
0170	<u>2.3.2 Detyrimet e ofruara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale shqiptare ose të një vendi të huaj</u> <i>Neni 13, pika 1, shkronja “b”, nënpika “ii” e rregullores</i>

	Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 2.3 që ofrohet nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale shqiptare ose të një vendi të huaj.
0180	2.3.3 Detyrimet e ofruara nga njësitë e sektorit publik shqiptar ose të një vendi të huaj <i>Neni 13, pika 1, shkronja “b”, nënpika “iii” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 2.3 që ofrohet nga njësitë e sektorit publik shqiptar ose të një vendi të huaj.
0190	2.3.4 Detyrimet e ofruara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare <i>Neni 13, pika 1, shkronja “b”, nënpika “iv” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 2.3 që ofrohet nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare.
0200	2.3.5 Detyrimet e ofruara nga klientët korporata jofinanciare <i>Neni 13, pika 1, shkronja “b”, nënpika “v” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 2.3 që ofrohet nga klientët korporata jofinanciare.
0210	2.3.6 Detyrimet e ofruara nga shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet, kompanitë e investimeve personale ose ndërmjetës depozitash (<i>deposit brokers</i>) <i>Neni 13, pika 1, shkronja “b”, nënpika “vi” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 2.3 që ofrohet nga shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, kompanitë e investimeve personale ose ndërmjetës depozitash (<i>deposit brokers</i>).
0220	2.4 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrime ose lehtësi të parevokueshme ose të anulueshme me kushte brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial <i>Neni 9 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht, detyrimet dhe lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte, të lejuara nga Banka e Shqipërisë për trajtimin preferencial, në përputhje me nenin 9 të rregullores.
0230	2.5 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientët financiarë dhe bankat qendrore

	Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e zërave nga seksioni 2.5.1 në seksionin 2.5.3.
0240	2.5.1 Detyrimet e ofruara nga Banka e Shqipërisë <i>Neni 12, pika 3, shkronja “b”, nënpika “i” dhe neni 13, pika 1, shkronja “c”, nënpika “i” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet e ofruara nga Banka e Shqipërisë, pavarësisht nëse janë të lidhura ose jo me transaksionet e financimit nëpërmjet titujve.
0250	2.5.2 Detyrimet e ofruara nga banka qendrore e një vendi të huaj <i>Neni 12, pika 3, shkronja “b”, nënpika “ii” dhe neni 13, pika 1, shkronja “c”, nënpika “ii” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet e ofruara nga banka qendrore e një vendi të huaj, pavarësisht nëse janë të lidhura ose jo me transaksionet e financimit nëpërmjet titujve.
0260	2.5.3 Detyrimet e ofruara nga klientët financiarë <i>Neni 12, pika 3, shkronja “b”, nënpika “iii” dhe neni 13, pika 1, shkronja “c”, nënpika “iii” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet e ofruara nga klientët financiarë, pavarësisht nëse janë të lidhura ose jo me transaksionet e financimit nëpërmjet titujve.
0270	2.5.3.1 depozitat operacionale <i>Neni 13, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht pjesën e depozitave operacionale nga klientët financiarë, në përputhje me nenin 22 të rregullores së mbulimit me likuiditet, që është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve operacionale. Depozitat që krijohen si rezultat i një marrëdhënieje me një bankë korrespondente ose nga ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit (<i>prime brokerage</i>), nuk trajtohen si depozita operacionale, në përputhje me nenin 22, pika 4, të rregullores së mbulimit me likuiditet dhe do të raportohen në seksionin 2.5.3.3. Depozitat operacionale sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 22 të rregullores së mbulimit me likuiditet, nuk duhet të raportohen në këtë rresht, por në seksionin 2.3. Pjesa e mbetur e depozitave operacionale, përtej shumës së nevojshme për ofrimin e shërbimeve operacionale, nuk raportohet në këtë rresht, por në seksionin 2.5.3.2.

0280	2.5.3.2 <u>teprica e depozitave operacionale</u> Bankat raportojnë në këtë rresht tepricën (pjesën e mbetur) e depozitave operacionale nga klientët financiarë, përtej shumës së nevojshme që kërkohet për ofrimin e shërbimeve operacionale. Depozitat operacionale sipas shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 22 të rregullores së mbulimit me likuiditet, nuk duhet të raportohen në këtë rresht, por në seksionin 2.3.
0290	2.5.3.3 <u>detyrime të tjera</u> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet e ofruara nga klientët financiarë që nuk janë depozita operacionale, ku kundërpartia mund të identifikohet. Pjesa e mbetur e depozitave operacionale, përtej shumës së nevojshme për ofrimin e shërbimeve operacionale, nuk raportohet në këtë rresht, por në seksionin 2.5.3.2.
0300	2.6 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e ofruara, ku kundërpartia nuk mund të përcaktohet</u> <i>Neni 12, pika 3, shkronja “c” dhe neni 13, pika 1, shkronja “d” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet ku kundërpartia nuk mund të përcaktohet, përfshirë edhe tituj të emetuar ku mbajtësi i tyre nuk mund të identifikohet.
0310	2.7 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet neto të derivativëve</u> <i>Neni 12, pika 4 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht diferencën negative midis grupeve të netimit, të llogaritur në përputhje me pikën 4 të nenit 12 të rregullores.
0320	2.8 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e tjera</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e zërave nga seksioni 2.8.1 në seksionin 2.8.4.
0330	2.8.1 <u>Detyrimet për t’u paguar sipas datës së tregtimit</u> <i>Neni 12, pika 3, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumat/detyrimet për t’u paguar sipas datës së tregtimit që shkaktohen nga blerja e instrumenteve financiare, e monedhave të huaja dhe e mallrave (<i>commodities</i>), që pritet të shlyhen brenda ciklit standard të shlyerjes ose periudhës standarde për shkëmbimin përkatës ose llojin e transaksioneve, ose që nuk kanë arritur të shlyhen por pritet që të shlyhen ndërkohë.

0340	2.8.2 Detyrimet tatimore të shtyra <i>Neni 12, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet tatimore të shtyra dhe do të konsiderojnë si maturitet të mbetur datën më të afërt të mundshme në të cilën mund të realizohen këto detyrime.
0350	2.8.3 Interesat e pakicës <i>Neni 12, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht interesat e pakicës dhe konsiderojnë si maturitet të mbetur afatin e instrumentit përkatës.
0360	2.8.4 Detyrime të tjera <i>Neni 12, pikat 1 dhe 3 të rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet e tjera, përfshirë pozicionet në shitje dhe pozicionet me afat të hapur/të papërcaktuar maturimi (<i>open maturity positions</i>).

PJESA IV: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR I THJESHTUAR

1. Shënime specifike

23. Bankat raportojnë në kategorinë përkatëse të gjitha aktivet për të cilat zotërojnë pronësinë, edhe nëse nuk mbahen në bilancin e bankës. Aktivet mbi të cilat bankat nuk zotërojnë pronësinë, nuk duhet të raportohen, edhe nëse aktivet mbahen në bilancin e bankës.
24. Në përputhje me nenin 37 të rregullores, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në Kreun VIII, shuma e financimit të qëndrueshëm të kërkuar llogaritet duke shumëzuar vlerën e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit me faktorët e financimit të qëndrueshëm të kërkuar.
25. Aktivet që kualifikohen si aktive likuide në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, raportohen si të tilla, pavarësisht nëse plotësojnë ose jo kërkesat operationale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërcituar. Këto aktive raportohen në kolonat përkatëse, pavarësisht maturitetit të mbetur.
26. Të gjitha aktivet jolikuide dhe zërat jashtë bilancit raportohen të ndara sipas maturitetit të tyre të mbetur, në përputhje me nenin 38 të rregullores. Shportat e maturitetit për vlerat, për faktorët standardë të financimit të qëndrueshëm të kërkuar dhe për faktorët e zbatueshëm të financimit të qëndrueshëm të kërkuar, janë të ndara si më poshtë:
 - i. maturitet i mbetur prej më pak se 1 viti ose pa maturitet të përcaktuar;
 - ii. maturitet i mbetur prej 1 viti ose më shumë.
27. Kur llogaritet maturiteti i mbetur i aktiveve jolikuide dhe zërave jashtë bilancit, bankat marrin në konsideratë edhe opsionet, bazuar në supozimin se emetuesi ose kundërpartia do të ushtrojë çdo opsion për të zgjatur maturitetin e aktiveve. Për opsionet e ushtruara në diskrecionin e bankës, banka duhet të marrë në konsideratë faktorët reputacionalë që mund të kufizojnë aftësinë e saj për të mos e ushtruar opsionin, në veçanti duke konsideruar pritshmëritë e tregjeve dhe klientëve që banka duhet të zgjasë maturitetin e aktiveve të caktuara në datën e maturimit të tyre.
28. Për disa zëra, bankat duhet t'i raportojnë aktivet sipas statusit të tyre dhe/ose maturimit të barrësimit të aktivit të caktuar, në përputhje me pikat 4-7 të nenit 37 të rregullores.
29. Siç përcaktohet në nenin 37, pika 6, të rregullores, ku një bankë ripërdor ose rivendos peng një aktiv të marrë hua, përfshirë edhe në transaksionet e financimit nëpërmjet titujve, dhe nëse ky aktiv mbahet si zë jashtë bilancit, transaksioni nëpërmjet të cilit aktiv i është marrë hua, do të trajtohet si i barrësuar, me kusht që ky transaksion nuk mund të maturohet nëse banka nuk e ka kthyer aktivin e marrë hua.

1.1 Udhëzime për kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010-0020	<u>Vlera e aktiveve jolikuide</u> Bankat raportojnë në kolonat 0010-0020 vlerën e aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të referuar në nënkreun II të kreut VIII të rregullores, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në Kreun VIII të rregullores. Vlera do të raportohet në kolonat 0010-0020 kur zëri përkatës nuk njihet si aktiv likuid në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operationale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërpërmendur.
0030	<u>Vlera e aktiveve likuide</u> <i>Referojuni udhëzimeve në kolonat 0010-0020</i> Vlera do të raportohet në kolonën 0030 kur zëri përkatës është klasifikuar si aktiv likuid, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operationale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërpërmendur.
0040-0060	<u>Faktori standard i financimit të qëndrueshëm të kërkuar</u> <i>Nënkreu II i kreut VIII të rregullores</i> Faktorët standardë në kolonat 0040-0060 janë ata faktorë të përcaktuar në kreun VIII të rregullores, që do të përcaktojnë pjesën e vlerës së aktiveve dhe zërave jashtë bilancit që përbëjnë financimin e qëndrueshëm të kërkuar. Faktorët standardë në kolonat 0040-0060 paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk duhet të plotësohen ose ndryshohen nga bankat.
0070-0090	<u>Faktori i zbatuar i financimit të qëndrueshëm të kërkuar</u> <i>Kreu III dhe kreut VIII i rregullores</i> Bankat raportojnë në kolonat 0070-0090 faktorët e zbatuar për zërat e parashikuar në kreun VIII të rregullores. Faktorët e zbatuar mund të rezultojnë në vlera mesatare të ponderuara dhe duhet të raportohen në numra dhjetorë (d.m.th. 1.00 për një normë të zbatueshme prej 100%, ose 0.50 për një normë të zbatueshme prej 50%). Faktorët e zbatuar mund të reflektojnë, por nuk kufizohen në, karakteristikat specifike të bankës apo të vendit.
0100	<u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar</u> Bankat raportojnë në kolonën 0100 financimin e qëndrueshëm të kërkuar në përputhje me kreun VIII të rregullores.

	Financimi i qëndrueshëm i kërkuar llogaritet sipas formulës së mëposhtme: c 0100= Shuma {(c 0010 * c 0070), (c 0020 * c 0080), (c 0030 * c 0090)}
--	--

1.2 Udhëzime për rreshtat specifike

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010	1. <u>FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR</u> <i>Kreu VIII i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht zërat subjekte të financimit të qëndrueshëm të kërkuar, në përputhje me kreun VIII të rregullores.
0020	1.1 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e bankës qendrore</u> <i>Neni 39, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet e bankës qendrore.
0030	1.1.1 <u>arka, rezerva dhe ekspozime likuide në bankën qendrore</u> Bankat raportojnë në këtë rresht arkën (paratë <i>cash</i>) dhe rezervat në bankën qendrore, përfshirë edhe tepricën në llogarinë e rezervës së detyruar. Bankat raportojnë në këtë rresht edhe çdo ekspozim tjetër ndaj bankës qendrore që konsiderohet si aktiv likuid në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operationale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërpërmendur. Rezervat e detyrueshme që nuk konsiderohen si aktive likuide në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, duhen të raportohen në kolonën përkatëse të aktiveve jolikuide.
0040	1.1.2 <u>ekspozime të tjera jolikuide ndaj bankës qendrore</u> Bankat raportojnë në këtë rresht çdo pretendim tjetër ndaj bankës qendrore, të ndryshëm nga ato të raportuara në seksionin 1.1.1.
0050	1.2 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet likuide</u> <i>Nenet 38 deri në 42 dhe neni 44 i rregullores</i>

	Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet likuide, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operationale të parashikuara në nenin 9 të rregullores së sipërpërmendur.
0060	1.2.1 <u>aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 0% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen/klasifikohen si aktive likuide të nivelit 1, në përputhje me nenin 11 të rregullores së mbulimit me likuiditet.
0070	1.2.1.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.1 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0080	1.2.1.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0090	1.2.1.3 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0100	1.2.2 <u>aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 10% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen si aktive likuide të nivelit 1 mbi të cilat zbatohet një haircut prej 10%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0110	1.2.2.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.2 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0120	1.2.2.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muaj, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.2 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por

	më pak se 1 vit.
0130	<u>1.2.2.3 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.2 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0140	<u>1.2.3 aktivet e nivelit 1 të klasifikuara për 15% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen si aktive likuide të nivelit 1 mbi të cilat zbatohet një haircut prej 15%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0150	<u>1.2.3.1 të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.3 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0160	<u>1.2.3.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.3 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit.
0170	<u>1.2.3.3 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.3 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0180	<u>1.2.4 aktive të nivelit 2A të klasifikuara për 15% haircut për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML)</u> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen/klasifikohen si aktive të nivelit 2A mbi të cilat zbatohet një haircut prej 15%, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0190	<u>1.2.4.1 të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.4 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh.
0200	<u>1.2.4.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por më pak se 1 vit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.4 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej të paktën 6 muajsh, por

	më pak se 1 vit.
0210	1.2.4.3 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.4 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0220	1.2.5 aktive të nivelit 2B të klasifikuara për qëllime të raportit të mbulimit me likuiditet (RML) Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet që njihen/klasifikohen si aktive të nivelit 2B, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet.
0230	1.2.5.1 të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.5 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.
0240	1.2.5.2 të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.2.5 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0250	1.3 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga titujt, përveç aktiveve likuide <i>Neni 43, pika 1, shkronja “b”; neni 45, pika 1, shkronja “e”; dhe neni 46, pika 1, shkronja “b” e rregullores.</i> Bankat raportojnë në këtë rresht titujt që nuk janë me probleme dhe që nuk janë klasifikuar si aktive likuide, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse plotësohen ose jo kërkesat operationale të parashikuara në rregulloren e sipërpërmendur.
0260	1.3.1 të pabarrësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.3 që lidhet me aktivet që janë të pabarrësuar ose të barrësuar për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.
0270	1.3.2 të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.3 që lidhet me aktivet që janë të barrësuar për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0280	1.4 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kreditë

	Bankat raportojnë në këtë rresht, paratë për t'u marrë nga kreditë që nuk janë me probleme. Siç përcaktohet në nenin 38, pika 3 e rregullores, për kreditë me këste me një maturitet kontraktual të mbetur prej 1 viti ose më shumë, çdo pjesë e kredisë që maturohet në më pak se 6 muaj dhe çdo pjesë që maturohet midis 6 muajsh dhe më pak se 1 viti, do të trajtohet përkatësisht si kredi me maturitet të mbetur prej më pak se 6 muajsh dhe midis 6 muajsh dhe më pak se 1 viti.
0290	1.4.1 <u>kredi për klientët jofinanciarë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4 që lidhet me kreditë për klientët jofinanciarë.
0300	1.4.1.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti</u> <i>Neni 43, pika 1, shkronja "a" dhe neni 45, pika 1, shkronja "b" e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.1 që lidhet me aktivet e pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.
0310	1.4.1.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> <i>Neni 46, pika 1, shkronja "b" e rregullores.</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.1 që lidhet me aktivet që janë të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0320	1.4.2 <u>kredi për klientët financiarë</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4 që lidhet me kreditë për klientët financiarë.
0330	1.4.2.1 <u>të pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti</u> <i>Neni 43, pika 1, shkronja "a" dhe neni 46, pika 1, shkronja "b" e rregullores.</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2 që lidhet me aktivet e pabarrësuara ose të barrësuara për një maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.
0340	1.4.2.2 <u>të barrësuara për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> <i>Neni 46, pika 1, shkronja "b" e rregullores</i>

	Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4.2 që lidhet me aktivet që janë të barrësura për një maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0350	1.4.3 produktet e lidhura me zërat e bilancit, të financimit tregtar <i>Neni 43, pika 1, shkronja “b” dhe neni 45, pika 1, shkronja “c” e rregullores.</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.4, që rezulton nga produktet e lidhura me zërat e bilancit të financimit tregtar.
0360	1.5 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial</u> <i>Neni 9 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht aktivet e lejuara nga Banka e Shqipërisë për trajtimin preferencial në përputhje me nenin 9 të rregullores.
0370	1.6 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga derivativët</u> <i>Neni 7, neni 40, pika 2; neni 45, pika 1, shkronja “a”; dhe neni 46, pika 2 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar që krijohet nga derivativët.
0380	1.6.1 <u>financimi i qëndrueshëm i kërkuar për pasivet e derivativëve</u> <i>Neni 40, pika 2 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.6, e cila është vlera e drejtë absolute e grupit të netimit me një vlerë të drejtë negative, të llogaritur në përputhje me nenin 40, pika 2 të rregullores.
0390	1.6.2 <u>financimi i qëndrueshëm i kërkuar për aktivet e derivativëve</u> <i>Neni 7 dhe neni 46, pika 2 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.6, e cila llogaritet si diferenca pozitive midis grupeve të netimit (kompensimit), të llogaritur në përputhje me nenin 46, pika 2, të rregullores.
0400	1.6.3 <u>marzhi fillestar i vendosur</u> <i>Neni 45, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.6 që lidhet me marzhin fillestar të vendosur për kontratat e derivativëve.

0410	<u>1.7 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kontributet në fondin e garancisë së një kundërpattie qendrore</u> <i>Neni 45, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht zërat e vendosur si kontribut në fondin e garancisë së një kundërpattie qendrore.
0420	<u>1.8 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e tjera</u> Bankat raportojnë në këtë rresht çdo lloj aktivi që nuk është raportuar në seksionet 1.1 - 1.7.
0430	<u>1.9 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga zërat jashtë bilancit</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e zërave jashtë bilancit që nuk referohen në seksionet 1.1 - 1.8 dhe i nënshtrohen kriterëve për financimin e qëndrueshëm të kërkuar.
0440	<u>1.9.1 lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte brenda grupit, subjekt i trajtimit preferencial</u> <i>Neni 9 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.9 që lidhet me lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte, të lejuara nga Banka e Shqipërisë për trajtimin preferencial, në përputhje me nenin 9 të rregullores.
0450	<u>1.9.2 lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte</u> <i>Neni 40, pika 1 e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.9 që lidhet me lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte, në përputhje me rregulloren e mbulimit me likuiditet, që nuk janë raportuar në seksionin 1.9.1.
0460	<u>1.9.3 zërat jashtë bilancit të financimit tregtar</u> <i>Neni 41 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.9 që lidhet me produktet e lidhur me zërat jashtë bilancit të financimit tregtar, siç përcaktohen në aneksin 2 të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
0470	<u>1.9.4 zërat jashtë bilancit me probleme</u> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e raportuar në seksionin 1.9 që lidhet me ekspozimet me probleme.

PJESA V: FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM I THJESHTUAR

1. Shënime specifike

30. Të gjitha detyrimet dhe zërat e kapitalit rregullator duhet të raportohen të klasifikuara sipas maturitetit të mbetur kontraktual, në përputhje me nenin 31 të rregullores. Shportat e maturitetit për vlerat, për faktorët standardë të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm dhe për faktorët e zbatueshëm të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, janë të ndara si më poshtë:
- i. maturitet i mbetur prej më pak se 1 vit ose pa maturitet të përcaktuar;
 - ii. maturitet i mbetur prej 1 viti ose më shumë.
31. Bankat, për të gjitha pasivet me maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë, zbatojnë një faktor të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 100%, me përjashtim kur specifikohet ndryshe në nenet 32-35 të rregullores, në përputhje me nenin 36 të rregullores.
32. Të gjitha depozitat pa afat (*sight deposits*) duhet të raportohen në kategorinë e detyrimeve me maturitet të mbetur prej më pak se 1 viti.
33. Në përputhje me nenin 31, pika 2 të rregullores, bankat duhet të marrin në konsideratë opsionet ekzistuese për të përcaktuar maturitetin e mbetur të një detyrimi ose të zërave të kapitalit rregullator, duke supozuar se kundërpartia do të ushtrojë opsionet *call* (*call options*) në datën më të shpejtë të mundshme. Për opsionet që ushtrohen në diskrecionin e bankës, banka merr parasysh faktorët reputacionalë që mund të kufizojnë aftësinë e saj për të mos ushtruar opsionin, në veçanti pritshmëritë e tregut që banka duhet të shlyejë detyrime të caktuara përpara maturitetit të tyre.
34. Gjithashtu, siç përcaktohet në nenin 36 të rregullores, për zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë, zërat e kapitalit të nivelit të dytë, dhe instrumente të tjera të kapitalit me opsione të qarta ose të përfshira (*explicit or embedded options*), të cilat, nëse ushtrohen (edhe nëse nuk janë ushtruar ende në datën referencë të raportimit), do të reduktonin maturitetin e mbetur efektiv në datën referencë të raportimit në më pak se 1 vit, nuk duhet të zbatohet një faktor i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm prej 100%.
35. Në përputhje me nenin 31, pika 3, të rregullores, bankat trajtojnë depozitat me një periudhë njoftimi të përcaktuar, në përputhje me periudhën e njoftimit të tyre, dhe depozitat me afat, në përputhje me maturitetin e mbetur të tyre. Pa rënë ndesh me paragrafin 33 më sipër, bankat, për të përcaktuar maturitetin e mbetur të depozitave me pakicë me afat, nuk marrin parasysh opsionet për tërheqje të parakohshme, kur depozituesi duhet të paguajë një penalitet të konsiderueshëm për tërheqjet e parakohshme të kryera në më pak se 1 vit, penalitet i cili është materialisht më i lartë se humbja e interesit të përlogaritur deri në datën e tërheqjes, siç përcaktohet në pikën 5 të nenit 21 të rregullores së mbulimit me likuiditet.

1.1 Udhëzime për kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010-0020	<u>Vlera</u> Bankat raportojnë në kolonat 0010-0020 shumën e detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator, të ndara sipas shportave të maturitetit të mbetur të tyre.
0030-0040	<u>Faktori standard i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm</u> <i>Nënkreu II i kreut VII të rregullores</i> Faktorët standardë në kolonat 0030-0040 janë ata faktorë të përcaktuar në kreun VII të rregullores, që do të përcaktojnë pjesën e vlerës së detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator që përbën financimin e qëndrueshëm të disponueshëm. Faktorët standardë në kolonat 0030-0040 paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk duhet të plotësohen ose ndryshohen nga bankat.
0050-0060	<u>Faktori i zbatuar i financimit të qëndrueshëm të disponueshëm</u> <i>Kreu III dhe kreut VII i rregullores</i> Bankat raportojnë në kolonat 0050-0060 faktorët e zbatuar të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm, si pesha që, pasi shumëzohen me detyrimet ose zërat e kapitalit rregullator, do të përcaktojnë shumën përkatëse të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm. Faktorët e zbatuar mund të rezultojnë në vlera mesatare të ponderuara dhe duhet të raportohen në numra dhjetorë (d.m.th. 1.00 për një normë të zbatueshme prej 100%, ose 0.50 për një normë të zbatueshme prej 50%). Faktorët e zbatuar mund të reflektojnë, por nuk kufizohen në, karakteristikat specifike të bankës apo të vendit.
0070	<u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm</u> Bankat raportojnë në kolonën 0070 financimin e qëndrueshëm të disponueshëm në përputhje me përcaktimet e nenit 30 të rregullores. Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm llogaritet sipas formulës së mëposhtme: c 0070= Shuma {(c 0010 * c 0050), (c 0020 * c 0060)}

1.2 Udhëzime për rreshtat specifike

Reshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010	2. <u>FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM</u> <i>Kreu VII i rregullores</i>
0020	2.1 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga zërat dhe instrumentet e kapitalit</u> <u>Kapitali bazë i nivelit të parë</u> <i>Neni 36, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë zërat e kapitalit bazë të nivelit të parë, para aplikimit të filtrave prudencialë, reduktimeve dhe përjashtimeve të parashikuara në nenet 7-11 dhe në nenin 20 të rregullores së kapitalit rregullator. <u>Kapitali shtesë i nivelit të parë</u> <i>Neni 36, pika 1, shkronja “b” e rregullores.</i> Bankat raportojnë zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë, përpara aplikimit të zbritjeve të përcaktuara në nenin 25 të rregullores së kapitalit rregullator. <u>Kapitali i nivelit të dytë</u> <i>Neni 36, pika 1, shkronja “c” e rregullores</i> Bankat raportojnë zërat e kapitalit të nivelit të dytë, përpara aplikimit të zbritjeve të përcaktuara në nenin 33 të rregullores së kapitalit rregullator. <u>Instrumente të tjera kapitali</u> <i>Neni 36, pika 1, shkronja “d” dhe neni 32, pika 3, shkronja “c” e rregullores</i> Bankat raportojnë instrumente të tjera të kapitalit, që nuk raportohen në kategoritë e sipërpërmendura.
0030	2.2 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat me pakicë</u> <i>Neni 30, pika 2 e rregullores</i> Bankat raportojnë obligacionet dhe tituj të tjerë të borxhit të emetuar nga banka, të cilat janë shitur ekskluzivisht në tregun me pakicë dhe mbahen në llogari me pakicë. Obligacionet me pakicë duhet të raportohen gjithashtu brenda kategorisë përkatëse të

	depozitave me pakicë, si “depozita të qëndrueshme me pakicë” ose “depozita të tjera me pakicë”, sipas seksioneve 2.2.1 dhe 2.2.2. <i>Neni 31, pika 3 e rregullores</i> Bankat raportojnë depozitat me pakicë që maturohen jo përpara 1 viti, por që mund të tërhiqen përpara 1 viti, kundrejt pagesës së penaltetit që vlerësohet si i konsiderueshëm, në përputhje me pikën 5 të nenit 21 të rregullores së mbulimit me likuiditet, brenda kategorisë përkatëse të depozitave me pakicë, si “depozita të qëndrueshme me pakicë” ose “depozita të tjera me pakicë”, sipas seksioneve 2.2.1 dhe 2.2.2. Ky zë përfshin detyrimet e siguruara dhe të pasiguruara.
0040	2.2.1 <u>Depozita të qëndrueshme me pakicë</u> <i>Neni 35 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht pjesën e depozitave me pakicë të siguruar nga skema e sigurimit të depozitave, siç përcaktohet në legjislacionin shqiptar në fuqi për sigurimin e depozitave dhe nga skemat ekuivalente të sigurimit të depozitave në vendet e huaja, e cila është pjesë e një marrëdhënieje të krijuar më parë (<i>established relationship</i>) me bankën, gjë që e bën pothuajse të pamundur tërheqjen e depozitës; ose mbahet në formën e një llogarie rrjedhëse (transaksionesh), përkatësisht në përputhje me pikën 2 dhe 3 të nenit 20 të rregullores së mbulimit me likuiditet, dhe kur: • këto depozita nuk përmbushin kriteret për një normë më të lartë të flukseve dalëse në përputhje me pikat 2, 3 dhe 9 të rregullores së mbulimit me likuiditet, ku do të raportohen si “depozita të tjera me pakicë”; ose • këto depozita nuk janë marrë në vendet e huaja, ku aplikohet një normë e lartë e flukseve dalëse, në përputhje me nenin 21, pika 5 të rregullores së mbulimit me likuiditet, ku do të raportohen si “depozita të tjera me pakicë”.
0050	2.2.2 <u>Depozita të tjera me pakicë</u> <i>Neni 34 i rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht shumën e depozitave të tjera me pakicë, përveç atyre të përcaktuara si “depozita të qëndrueshme me pakicë” në seksionin 2.2.1.
0060	2.3 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientë të tjerë jofinanciarë (përveç bankave qendrore)</u> <i>Neni 33, pika 1, shkronja “b” e rregullores</i> Bankat raportojnë detyrimet e ofruara nga klientë jofinanciarë me shumicë (përveç bankave qendrore).

	<u>Detyrime të ofruara nga Qeveria Shqiptare ose qeveria qendrore e një vendi të huaj</u> <i>Neni 33, pika 1, shkronja “b”, nënpika “i” e rregullores</i> <u>Detyrimet e ofruara nga qeveritë rajonale ose autoritetet lokale shqiptare ose të një vendi të huaj</u> <i>Neni 33, pika 1, shkronja “b”, nënpika “ii” e rregullores</i> <u>Detyrimet e ofruara nga njësitë e sektorit publik shqiptar ose të një vendi të huaj</u> <i>Neni 33, pika 1, shkronja “b”, nënpika “iii” e rregullores</i> <u>Detyrimet e ofruara nga bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe organizatat ndërkombëtare</u> <i>Neni 33, pika 1, shkronja “b”, nënpika “iv” e rregullores</i> <u>Detyrimet e ofruara nga klientët korporata jofinanciare</u> <i>Neni 33, pika 1, shkronja “b”, nënpika “v” e rregullores</i> <u>Detyrimet e ofruara nga shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet, kompanitë e investimeve personale ose ndërmjetës depozitash (deposit brokers)</u> <i>Neni 33, pika 1, shkronja “b”, nënpika “vi” e rregullores</i>
0070	2.4 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat operacionale</u> <i>Neni 33, pika 1, shkronja “a” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht pjesën e depozitave operacionale, në përputhje me nenin 22 të rregullores së mbulimit me likuiditet, që është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve operacionale.
0080	2.5 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrime ose lehtësi të parevokueshme ose të anulueshme me kushte brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial</u> <i>Neni 9 i rregullores</i>

	Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet dhe lehtësitë e parevokueshme ose të anulueshme me kushte, të lejuara nga Banka e Shqipërisë për trajtimin preferencial, në përputhje me nenin 9 të rregullores.
0090	2.6 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientët financiarë dhe bankat qendrore</u> <i>Neni 32, pika 3, shkronja “b” dhe neni 36, pika 1, shkronja “e” e rregullores</i> <u>Detyrimet e ofruara nga Banka e Shqipërisë</u> <i>Neni 32, pika 3, shkronja “b”, nënpika “i” e rregullores</i> Bankat raportojnë detyrimet e ofruara nga Banka e Shqipërisë, pavarësisht nëse janë të lidhura ose jo me transaksionet e financimit nëpërmjet titujve. <u>Detyrimet e ofruara nga banka qendrore e një vendi të huaj</u> <i>Neni 32, pika 3, shkronja “b”, nënpika “ii” e rregullores</i> Bankat raportojnë detyrimet e ofruara nga banka qendrore e një vendi të huaj, pavarësisht nëse janë të lidhura ose jo me transaksionet e financimit nëpërmjet titujve. <u>Detyrimet e ofruara nga klientët financiarë</u> <i>Neni 32, pika 3, shkronja “b”, nënpika “iii” e rregullores</i> Bankat raportojnë detyrimet e ofruara nga klientët financiarë, pavarësisht nëse janë të lidhura ose jo me transaksionet e financimit nëpërmjet titujve. <u>Detyrimet e ofruara nga klientët financiarë dhe bankat qendrore, me maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë</u> <i>Neni 36, pika 1, shkronja “e” e rregullores</i> Bankat raportojnë detyrimet e ofruara nga klientët financiarë dhe bankat qendrore, me maturitet të mbetur prej 1 viti ose më shumë.
0100	2.7 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e ofruara, ku kundërpartia nuk mund të përcaktohet</u> <i>Neni 32, pika 3, shkronja “c” dhe neni 36, pika 1, shkronja “e” e rregullores</i> Bankat raportojnë në këtë rresht detyrimet ku kundërpartia nuk mund të përcaktohet, përfshirë edhe tituj të emtuar ku mbajtësi i tyre nuk mund të identifikohet.

0110	2.8 <u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e tjera</u> <u>Detyrimet për t'u paguar sipas datës së tregtimit</u> <i>Neni 32, pika 3, shkronja "a" e rregullores</i> Bankat raportojnë detyrimet për t'u paguar sipas datës së tregtimit, që shkaktohen nga blerja e instrumenteve financiare, e monedhave të huaja dhe mallrave (<i>commodities</i>), që pritët të shlyhen brenda ciklit standard të shlyerjes ose periudhës standarde për shkëmbimin përkatës ose llojin e transaksioneve, ose që nuk kanë arritur të shlyhen, por pritët që të shlyhen ndërkohë. <u>Detyrimet tatimore të shtyra</u> <i>Neni 32, pika 1, shkronja "a" e rregullores</i> Bankat raportojnë detyrimet tatimore të shtyra dhe do të konsiderojnë si maturitet të mbetur, datën më të afërt të mundshme në të cilën mund të realizohen këto detyrime. <u>Interesat e pakicës</u> <i>Neni 32, pika 1, shkronja "b" e rregullores</i> Bankat raportojnë interesat e pakicës dhe konsiderojnë si maturitet të mbetur, afatin e instrumentit përkatës. <u>Detyrime të tjera pa maturitet të përcaktuar</u> <i>Neni 32, pika 1 e rregullores</i> Banka raportojnë detyrimet e tjera pa maturitet të përcaktuar, përfshirë pozicionet në shitje dhe pozicionet me afat të hapur/të papërcaktuar maturiteti, përveçse kur përcaktohet ndryshe në kreun VII të rregullores. <u>Detyrime neto të derivativëve</u> <i>Neni 32, pika 4 e rregullores.</i> Bankat raportojnë diferencën negative midis grupeve të netimit (kompensimit), të llogaritur në përputhje me pikën 4 të nenit 32 të rregullores. Të gjitha pasivet e derivativëve duhet të raportohen sikur të kenë maturitet të mbetur prej më pak se 1 vit.

	<u>Detyrime të tjera</u> <i>Neni 32, pika 3, shkronja “c” e rregullores.</i> Bankat raportojnë detyrimet e tjera, që nuk janë parashikuar në nenet 32 deri në 36 të rregullores. Të gjithë zërat e kapitalit duhet të raportohen në seksionin 2.1, pavarësisht maturitetit të mbetur të tyre.
--	--

PJESA VI: RAPORTI NETO I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM - PËRMBLEDHJE

1. Shënime specifike

36. Formulari F5 siguron informacion mbi raportin neto të financimit të qëndrueshëm, për bankat që raportojnë raportin e plotë neto të financimit të qëndrueshëm (formularët F1 dhe F2) dhe për bankat që raportojnë raportin e thjeshtuar neto të financimit të qëndrueshëm (formularët F3 dhe F4).
37. Në përputhje me nenin 5, pika 1, të rregullores, raporti neto i financimit të qëndrueshëm është i barabartë me raportin e financimit të qëndrueshëm të disponueshëm të bankave, siç përcaktohet në kreun IV dhe VII të rregullores, ndaj financimit të qëndrueshëm të kërkuar të bankave, siç përcaktohet në kreun V dhe VIII të rregullores, dhe shprehet në %. Rregullat e llogaritjes së raportit paraqiten në kreun III të rregullores.
38. Zërat në rreshtat 0010-0190 duhet të jenë të njëjtë si ekuivalentët e tyre të raportuar në formularët F1 – F4.

1.1 Udhëzime për kolonat specifike

Kolona	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010	<u>Vlera</u> Bankat raportojnë në kolonën 0010 shumën e aktiveve, zërave jashtë bilancit, detyrimeve dhe zërave të kapitalit rregullator, të shpërndara sipas shumave, të shportave të maturitetit të mbetur dhe kategorive të aktiveve likuide. Vlerat raportohen përpara aplikimit të faktorëve përkatës të financimit të qëndrueshëm të disponueshëm dhe të financimit të qëndrueshëm të kërkuar.
0020	<u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar</u> Bankat raportojnë në kolonën 0020 financimin e qëndrueshëm të kërkuar, të llogaritur në përputhje me kreun V dhe VIII të rregullores.

0030	<u>Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm</u> Bankat raportojnë në kolonën 0030 financimin e qëndrueshëm të disponueshëm, të llogaritur në përputhje me kreun IV dhe VII të rregullores.
0040	<u>Raporti</u> Bankat raportojnë në kolonën 0040 raportin neto të financimit të qëndrueshëm, në përputhje me nenin 5, pika 1, të rregullores.

1.2 Udhëzime për rreshtat specifike

Rreshti	Referencat e rregullores dhe udhëzime për plotësimin
0010	1. <u>FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR</u> Seksioni 1 i formularëve F1 dhe F3
0020	1.1 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e bankës qendrore</u> Seksioni 1.1 i formularëve F1 dhe F3
0030	1.2 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet likuide</u> Seksioni 1.2 i formularëve F1 dhe F3
0040	1.3 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga titujt, përveç aktiveve likuide</u> Seksioni 1.3 i formularëve F1 dhe F3
0050	1.4 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kreditë</u> Seksioni 1.4 i formularëve F1 dhe F3
0060	1.5 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial</u> Seksioni 1.5 i formularëve F1 dhe F3
0070	1.6 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga derivativët</u> Seksioni 1.6 i formularëve F1 dhe F3
0080	1.7 <u>Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga kontributet në fondin e garancisë së</u>

	<u>një kundërpattie qendrore</u> Seksioni 1.7 i formularëve F1 dhe F3
0090	<u>1.8 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga aktivet e tjera</u> Seksioni 1.8 i formularëve F1 dhe F3
0100	<u>1.9 Financimi i qëndrueshëm i kërkuar nga zërat jashtë bilancit</u> Seksioni 1.9 i formularëve F1 dhe F3
0110	<u>2. FINANCIMI I QËNDRUESHËM I DISPONUESHËM</u> Seksioni 2 i formularëve F2 dhe F4
0120	<u>2.1 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga zërat dhe instrumentet e kapitalit</u> Seksioni 2.1 i formularëve F2 dhe F4
0130	<u>2.2 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat me pakicë</u> Seksioni 2.2 i formularëve F2 dhe F4
0140	<u>2.3 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientë jofinanciarë (përveç bankave qendrore)</u> Seksioni 2.3 (me përjashtim të 2.3.0.2) i formularëve F2 dhe F4
0150	<u>2.4 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga depozitat operacionale</u> Seksioni 2.3.0.2 dhe 2.5.3.1 i formularit F2 dhe seksioni 2.4 i formularit F4
0160	<u>2.5 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrime ose lehtësi të parevokueshme ose të anulueshme me kushte brenda një grupi, subjekt i trajtimit preferencial</u> Seksioni 2.4 i formularit F2 dhe seksioni 2.5 i formularit F4
0170	<u>2.6 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga klientët financiarë dhe bankat qendrore</u> Seksioni 2.5 (me përjashtim të 2.5.3.1) i formularit F2 dhe seksioni 2.6 i formularit F4
0180	<u>2.7 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e ofruara, ku kundërpattia nuk mund të përcaktohet</u> Seksioni 2.6 i formularit F2 dhe seksioni 2.7 i formularit F4
0190	<u>2.8 Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm nga detyrimet e tjera</u> Seksioni 2.7 dhe 2.8 i formularit F2 dhe seksioni 2.8 i formularit F4
0200	<u>3. Raporti neto i financimit të qëndrueshëm</u> Raporti neto i financimit të qëndrueshëm llogaritet në përputhje me nenin 5, pika 1 të rregullores.